

EPOKA ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5576
E premte, 14 shtator 2018
çmimi 0.40 €

Thaçi: Marrëveshja Kosovë - Serbi do të ketë ndikim pozitiv në rajon

FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", RRUSTEM BERISHA | FAQE 4-5

Projektligjet parashohin kompetenca të reja për FSK-në

Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), Rrustem Berisha, e ka quajtur lajm të mirë miratimin e pakos së projektligjeve nga ana e Qeverisë, që rregullojnë rolin, funksionin dhe shërbimin e FSK-së. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se me miratimin e këtyre projektligjeve fillon procesi i transformimit të FSK-së deri në krijimin e rrethanave të përshtatshme për ndryshimet kushtetuese. Berisha ka bërë me dije se përmes këtyre projektligjeve parashihen kompetenca dhe detyra të reja për FSK-në, por jo edhe ndryshimi i emrit. Ai ka treguar se do të ketë rritje të numrit të pjesëtarëve të FSK-së nga 2 500 në 5 000. Ministri Berisha ka theksuar se si institucione kanë ndërmarrë një fushatë informuese me të gjitha shtetet partnere, ato të Quintit dhe shtetet e NATO-s për lëvizjet në këtë proces



AKTUALE

HARTAT E HAXHIUT SIPAS POROSIVE TË HASHIMIUT! F.11



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

LOGJIKJA E MILLOSHEVIQIT NË MENDJEN POLITIKE TË ALEKSANDËR VUÇIQIT F.11



Dr. SABRI KIÇMARI

VESELI U BËNË THIRRJE PËR UNITET POZITËS DHE OPOZITËS PËR VOTIMIN E PROJEKTLIGJEVE F.5

EKONOMI

ASK-ja: QEVERIA KA SHPENZUAR 461 MILIONË EURO PËR TRE MUAJ F.9

MATOSHI MERR PËRKRAHJE NGA KFOR-i PËR AKSIONIN 'TA PASTROJMË KOSOVËN' F.8

KULTURË

POEZI QË TA RIKUJTON NAIMIN E MADH F.10



Nga Rami KAMBERI

SPORT

'PROFA': PËR TITULL FLASIM NË JANAR F.15

LIMANI: BEKIM ISUFI, NJERIU I REKORDEVE DHE I SUKSESEVE F.15

PARLAMENTI EVROPIAN KA MIRATUAR REKOMANDIMIN E KOMITETIT PËR LIRITË CIVILE, DREJTËSI DHE ÇËSHTJE TË BRENDSHME (LIBE) PËR LIBERALIZIMIN E VIZAVE PËR KOSOVËN | FAQE 3

Parlamenti Evropian, fuqishëm pro liberalizimit për Kosovën

Me 420 vota për, 186 kundër dhe 22 abstenime, Parlamenti Evropian ka miratuar rekomandimin e Komitetit LIBE për liberalizim të vizave për Kosovën. Në këtë mënyrë Parlamenti Evropian ka dhënë dritën jeshile për fillimin e bisedimeve me vendet anëtare të BE-së për këtë proces. Ky votim është mirëpritur nga lidhshipi i Kosovës, i cili e ka vlerësuar këtë hap tjetër drejt liberalizimit të vizave



Sondazhi: Një vit pas, qytetarët të pakënaqur me punën e ekzekutivit dhe legjislativit

FAQE 6

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Pruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë, Viasat, p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Shqipëria fton shqiptarët e Maqedonisë ta mbështesin referendumin

SHKUP, 13 SHTATOR - Ministri i Punëve të Jashtme i Shqipërisë, Ditmir Bushati, u ka bërë thirrje shqiptarëve të Maqedonisë të votojnë në referendumin e 30 shtatorit për mbështetjen e marrëveshjes me Greqinë. Kjo marrëveshje vlerësohet vendimtare për të ardhmen e Maqedonisë, pasi zbatim i saj mundëson hyrje në NATO dhe nisjen e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian. "Dua që në emër të shtetit shqiptar t'u bashkohem të gjithë zërave, të gjithë miqve të vendit tuaj, duke u

bërë apel, sidomos shqiptarëve që jetojnë këtu, për ta mbështetur marrëveshjen historike të Prespës. Kjo marrëveshje, pavarësisht se shpesh konsiderohet marrëveshje për zgjidhjen e çështjes së emrit, në fakt ajo ka një rëndësi të madhe për stabilitetin demokratik në rajonin tonë dhe për perspektivën tonë të përbashkët euroatlantike", ka deklaruar në Shkup shefi i diplomacisë shqiptare pas takimit që ka pasur të enjten me ministrin e Punëve të Jashtme të Maqedonisë, Nikolla Dimitrov.

Bushati ka thënë se Shqipëria si vend anëtar i NATO-s mbështet pa asnjë kusht anëtarësimin e Maqedonisë në Aleancën Veriatlantike.

Ministri i Jashtëm i Maqedonisë ka përshëndetur qasjen konstruktive të Shqipërisë sa i përket procesit euroatlantik, ndërsa ka theksuar përkushtimin e dy vendeve për thellimin e mëtejshëm të bashkëpunimit. Dy ministrat njoftuan edhe për mbajtjen e shpejtë të një mbledhjeje të përbashkët mes dy qeverive.



Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka mbajtur konferencë me gazetarë

Thaçi: Marrëveshja Kosovë - Serbi do të ketë ndikim pozitiv në rajon

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, beson se një marrëveshje e mundshme në mes të Kosovës dhe Serbisë do të kishte ndikime pozitive për të gjithë rajonin. Shefi i shtetit ka ripërsëritur se procesi drejt kësaj marrëveshjeje do të jetë jashtëzakonisht kompleks, duke shtuar se, nëse opozita tenton ta bllokojë këtë marrëveshjeje në Kuvend, do të vijë në shprehje referendumi

"Epoka e re"

PRISHTINË, 13 SHTATOR - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka deklaruar se Kosova do të nënshkruajë marrëveshje me Serbinë vetëm nëse ajo i siguron asaj njohje reciproke. Në një konferencë me gazetarë ai ka deklaruar se një marrëveshje eventuale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë do të kishte ndikim pozitiv dhe në gjithë rajonin. "Ju informoj edhe për angazhimet në ditët e fundit për takimet, reflektimet dhe rrethanat e reja për mundësinë e arritjes së marrëveshjes përfundimtare. Kam rithesuar se marrëveshja Kosovë - Serbi është në interesin e dy shteteve, në të njëjtën kohë ka ndikimin e vet pozitiv edhe në rajon nëse arrihet. Procesi është jashtëzakonisht kompleks dhe i debatueshëm në rrafsh të gjerë, kështu që në kuadër të opinionëve të ndryshme, së pari politike, opinionëve të sinqerta, mund të

krijohen edhe divergjenca të ndryshme pro marrëveshjes apo kundër marrëveshjes", ka deklaruar presidenti Thaçi.

Ai ka deklaruar se nuk mund të ketë njohje e as marrëveshje me Serbinë pa demarkacionin e kufirit. "Do ta kemi demarkacionin e kufirit apo korigjimin e kufirit prej 430 kilometrash. Nuk mund të ketë njohje reciproke pa përmbylljen e këtij procesi apo paralelisht. Korigjimi i kufirit është i mundshëm dhe i siguron Kosovës njohje të drejtpërdrejtë nga Serbia, po ashtu edhe bashkimin e Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit me Kosovën", ka thënë Thaçi, duke përmendur ndikimet e tjera të marrëveshjes. "Njohja nga Serbia nënkupton njohje nga pesë vendet e Bashkimit Evropian për Kosovën, njohje nga Greqia, Spanja, Rumania, Sllovakia dhe Qiproja. Nënkupton menjëherë fillimin e procesit të Kosovës përmes themelimit të ushtrisë



dhe partneritet për paqe dhe rrugëtim të sigurt në NATO", është shprehur ai.

Shefi i shtetit ka bërë thirrje që ekipi negociator i Kosovës të formohet sa më shpejt në Kuvend, duke kërkuar edhe përkrahjen e opozitës, shoqërisë civile dhe medieve. Ai është zotuar se një marrëveshje e mundshme finale me Serbinë do të ketë përkrahje të vendeve në rajon, BE-së dhe

Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Presidenti Thaçi ka deklaruar se opozita nuk do ta mund ta ndalojë marrëveshjen Kosovë - Serbi ngaqë, sipas tij, në rast se kjo tentohet, do të vijë në shprehje referendumi. "Nuk kam të drejtë kushtetuese të jem pjesë e Kuvendit, mirëpo kur je në parlament të vlon barku dhe duhet të ngrihesh e të sqarosh. Në rast se arrihet marrëveshja historike

Kosovë - Serbi dhe jemi të bindur se është në interes të shtetit dhe jemi në koordinim me ShBA-në dhe Bashkimin Evropian, nuk do të mund një grup i caktuar ta mbajë peng këtë proces sepse do të organizojmë referendum dhe pyetja do të jetë shumë e qartë për qytetarët: jeni në favor të arritjes së kësaj marrëveshjeje për anëtarësim në Bashkimin Evropian po apo jo?", ka deklaruar Thaçi.

Presidenti Meta, drekë lamtumire me ambasadorin Donald Lu

TIRANË, 13 SHTATOR - Presidenti i Republikës, Ilir Meta, është takuar të enjten me ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë, Donald Lu, para largimit të diplomatit nga Shqipëria.

"Kënaqësi të kaloja një drekë lamtumire me ambasadorin e ShBA-së, Donald Lu, me të cilin bashkëpunuam për më se tre vjet për shtimin e marrëdhënieve midis dy vendeve tona. Me këtë rast e urova

ambasadorin për suksese në detyrën e re!", ka shkruar Meta. Edhe kryetarja e Lëvizjes Socialiste për Integrim, Monika Kryemadhi, priti të enjten në selinë e LSI-së, në takim lamtumirës, ambasadorin e

ShBA-së, Donald Lu. Kryetarja Kryemadhi falënderoi ambasadorin Lu dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës për mbështetjen e vazhdueshme që kanë dhënë për konsolidimin e demokracisë në Shqipëri.



Parlamenti Evropian ka miratuar rekomandimin e Komitetit për Liritë Civile, Drejtësi dhe Çështje të Brendshme (LIBE) për liberalizimin e vizave për Kosovën

Parlamenti Evropian fuqishëm pro liberalizimit për Kosovën

Me 420 vota për, 186 kundër dhe 22 abstenime, Parlamenti Evropian ka miratuar rekomandimin e Komitetit LIBE për liberalizim të vizave për Kosovën. Në këtë mënyrë Parlamenti Evropian ka dhënë dritën jeshile për fillimin e bisedimeve me vendet anëtare të BE-së për këtë proces. Ky votim është mirëpritur nga lideri i Kosovës, i cili e ka vlerësuar hap tjetër drejt liberalizimit të vizave

**EPOKA
ERE** **Muhamet KOÇI**

PRISHTINË, 13 SHTATOR - Parlamenti Evropian ka votuar të enjten pro liberalizimit të vizave për Kosovën. Me 420 vota për, 186 kundër dhe 22 abstenime, Parlamenti ka miratuar rekomandimin e Komitetit për Liritë Qytetare, Drejtësi dhe Çështje të Brendshme (LIBE), për liberalizimin e vizave për Kosovën. Me këtë votim të Parlamentit Evropian konfirmohet mandati për fillimin e dialogut trepalësh në mes të Parlamentit, Komisionit dhe Këshillit të Ministrave në mënyrë që Kosovës t'i liberalizohen vizat. Bisedimet në emër të Parlamentit Evropian do t'i udhëheqë Tanja Fajon,

raportuese për vizat në Parlament.

Pas votimit, përmes një postimi në "Twitter", Tanja Fajon ka shkruar se qytetarët e Kosovës janë edhe një hap më afër udhëtimit pa viza në Evropë. "Përpjekjet vazhdojnë me qeveritë e vendeve të BE-së dhe nuk do të ndalem derisa të liberalizohen vizat", ka shkruar Fajon. Ndërsa raportuesi për Kosovën në Parlamentin Evropian, Igor Soltes, përmes një postimi në "Twitter" ka deklaruar se Kosova është një hap më pranë regjimit pa viza, duke shtuar se qytetarët e Kosovës meritojnë mundësitë e njëjta. "Urime qytetarëve të Kosovës. Tani jemi një hap më afër liberalizimit të vizave. Shpresoj që edhe Këshilli i Evropës do ta ndjekë shembullin



e njëjtë. Qytetarët e Kosovës meritojnë mundësitë e njëjta", ka shkruar Soltes.

Kosova falënderon eurodeputetët për votimin

Votimi i Parlamentit Evropian pro liberalizimit të vizave është pritur me entuziazëm në Kosovës. Liderët institucionalë kanë falënderuar eurodeputetët për votimin, duke e vlerësuar këtë veprim hap të rëndësishëm drejt liberalizimit të vizave. Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se ky votim është një mesazh i qartë edhe për institucionet e tjera vendimarrëse në Bashkimin Evropian. "Qytetarët e Kosovës sot janë edhe një hap më afër drejt realizimit të një të drejte bazike në familjen evropiane, lëvizjen e lirë në Zonën Shengen. Me më shumë se 2/3 e votave të eurodeputetëve, Parlamenti Evropian votoi pro liberalizimit të vizave për qytetarët tanë. Ky është një mesazh i qartë edhe për institucionet e tjera vendimarrëse në Bashkimin Evropian. Jam i

bindur se brenda një periudhe të shkurtër kohore do të përmbillet tërësisht ky proces dhe qytetarët tanë, pas një rrugëtimi të gjatë dhe tejet të mundimshëm, së shpejti do të jenë të barabartë me të gjithë qytetarët e Bashkimit Evropian. Si president i Republikës së Kosovës, në emrin tim personal dhe të të gjithë qytetarëve të Kosovës, i falënderoj eurodeputetët për këtë vendim të drejtë", ka shkruar Thaçi në profilin e vet në "Facebook".

Edhe kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, në profilin e vet në "Facebook" ka vlerësuar se institucionet e Kosovës duhet ta vazhdojnë lobimin në qendrat e BE-së. "Pas votimit pro nga Parlamenti Evropian për liberalizimin e vizave, jemi edhe një hap më afër drejt lëvizjes së lirë. Institucionet e Kosovës do të vazhdojnë lobimin që ky proces të përmbillet brenda këtij viti. Qytetarët tanë e meritojnë këtë", ka shkruar Veseli.

Kurse kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka falënderuar të gjithë deputetët e PE-së për këtë votim. "Urime qytetarë të Kosovës! Së shpejti do të

lëvizni lirshëm në Evropë. Falënderues ndaj të gjithë deputetëve dhe grupeve parlamentare, të të gjitha partive e shteteve anëtare, që në Parlamentin Evropian e mbështetën të drejtën tonë për lëvizje të lirë", është shprehur ai në profilin e vet në "Facebook". Edhe zëvendëskryeministrat Behxhet Pacolli dhe Fatmir Limaj, si dhe ministrja e Integritetit Evropian, Dhurata Hoxha, e kanë mirëpritur këtë votim të PE-së. Ndërkaq kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Isa Mustafa, këtë votim e ka vlerësuar fitore të përbashkët të institucioneve të BE-së dhe përmbushjes së kriterëve nga shteti i Kosovës. "Është kjo fitore jonë e përbashkët, e institucioneve të BE-së, e përmbushjes së kriterëve nga shteti i Kosovës dhe e vetëdijesimit të atyre që kundërshtuan më shumë se dy vjet ratifikimin e marrëveshjes për kufirin me Malin e Zi. Të shpresojmë dhe të punojmë që edhe Këshilli i Ministrave i BE-së në të ardhmen e afërt të vendosë pozitivisht për liberalizimin e vizave", ka shkruar Mustafa në profilin e vet në "Facebook".



Mbahet takimi i tretë i grupit punues për Ligjin për Qeverinë

PRISHTINË, 13 SHTATOR - Koordinatori Nacional për Reforma Shtetërore, Besnik Tahiri, ka bërë me dije se të enjten kanë mbajtur takimin e tretë të grupit punues për hartimin e Projektligjit për Qeverinë. Ai ka thënë se në këtë takim kanë diskutuar për çështjet që duhet të trajtohen në këtë projektligj, siç janë definimi i sektorëve/dikasterëve për qev-

erisje, vendosja e kufijve për numrin e ministrave dhe zëvendësmministrave, fleksibilitetin e tepruar në këtë aspekt dhe kornizën ligjore ekzistuese. "Grupi punues u pajtua që në fillim të muajit tetor të përgatitë një dokument i cili vendos parametrat e Ligjit që rregullon dikasteret, fushën e veprimt dhe numrin e përgjithshëm të tyre, duke i siguruar Republikës së

Kosovës një qeverisje të mirë dhe efikase. Po ashtu, diskutuam edhe mbi kompetencat burimore të kryeministrit individualisht dhe Qeverisë si kolegji, dhe u pajtuam se në fokus të ligjit për Qeverinë duhet të jetë përputhshmëria me praktikën e vendeve të BE-së, si synim sublim i Qeverisë së Kosovës", ka shkruar Tahiri në llogarinë e vet në "Facebook".



Flet për "Epokën e re", Rrustem Berisha

Projektligjet parashohin kom

Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), Rrustem Berisha, e ka quajtur lajm të mirë miratimin e pakos së projektligjeve nga ana e Qeverisë, që rregullojnë rolin, funksionin dhe shërbimin e FSK-së. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se me miratimin e këtyre projektligjeve fillon procesi i transformimit të FSK-së deri në krijimin e rrethanave të përshtatshme për ndryshimet kushtetuese. Berisha ka bërë me dije se përmes këtyre projektligjeve parashihen kompetenca dhe detyra të reja për FSK-në, por jo edhe ndryshimi i emrit. Ai ka treguar se do të ketë rritje të numrit të pjesëtarëve të FSK-së nga 2 500 në 5 000. Ministri Berisha ka theksuar se si institucione kanë ndërmarrë një fushatë informuese me të gjitha shtetet partnere, ato të Quintit dhe shtetet e NATO-s për lëvizjet në këtë proces



EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 13 SHTATOR -

"Epoka e re": Z. Berisha, Qeveria e Kosovës në mbledhjen e së enjtes ka aprovuar pakon e projektligjeve që rregullojnë rolin, funksionin dhe shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës. Mund të na tregoni më konkretisht se çfarë përmban Projektligji për Forcën e Sigurisë së Kosovës, Projektligji për shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Projektligji për Ministrinë e Mbrojtjes?

Berisha: Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës ka proceduar për miratim në Qeverinë e Kosovës tri projektligje bazike të FSK-së. Të enjten është aprovuar Projektligji për Forcën e Sigurisë së Kosovës, Projektligji për shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Projektligji për Ministrinë e Mbrojtjes. Përmes këtyre tre projektligjeve parashihet që Forca e Sigurisë së Kosovës të zhvillohet si një forcë me kompetenca, me organizim dhe funksionim të ri si dhe kalimi i Ministrisë së FSK-së në Ministri të Mbrojtjes. Këto projektligje

nuk përmbajnë ndonjë ndryshim drastik.

"Epoka e re": Këto projektligje nuk parashohin ndryshimin e emrit të FSK-së, por vetëm ndryshimin e kompetencave, detyrave dhe funksionimit?

Berisha: Emri edhe më tutje do të jetë Forca e Sigurisë së Kosovës, por i shtohen kompetencat dhe detyrat. Me miratimin e këtyre projektligjeve realisht ne po fillojmë procesin e transformimit. Pra, ideja është të fillojmë procesin e transformimit deri kur të krijohen rrethanat për ndryshime kushtetuese që ndryshohet edhe emri. Tashmë projektligjet janë miratuar në Qeveri dhe është vendim i Qeverisë se kur do t'i procedojë në Kuvend për miratim.

"Epoka e re": Me anë të këtyre projektligjeve parashihet rritja e numrit të pjesëtarëve të FSK-së?

Berisha: Po. Me këtë parashihet edhe rritja e numrit të pjesëtarëve të FSK-së me që kanë të bëjnë me organizimin ashtu siç parashihet sipas rekomandimeve të rishikimit të sektorit strategjik të sigurisë.

"Epoka e re": Sa do të jetë numri i pjesëtarëve të FSK-së?

Berisha: Rritja e numrit të pjesëtarëve të FSK-së është paraparë nga 2 500 në 5 000 dhe pjesëtarët rezervë nga 800 në 3 000.

"Epoka e re": Parashihet edhe pajisja me armatim më të rëndë apo armatim shtesë?

Berisha: Kjo nuk është e paraparë me ligje, sepse ligji nuk parashihet armatimin, por ato parashihen me planin e transformimit të FSK-së dhe ka shumë faktorë të tjerë të cilët ndikojnë se cilat pajisje do t'i ketë FSK-ja. Është e drejtë e jona kushtetuese që ne t'i ndërtojmë kapacitetet mbrojtëse. Me këto ligje ne dëshirojmë t'i plotësojmë kapacitetet mbrojtëse dhe me të gjitha ato pajisje që nevojiten për detyra dhe kompetenca të reja do të pajiset Forca e Sigurisë së Kosovës.

"Epoka e re": Nga kjo që po thoni i bie se me miratimin e këtyre tri projektligjeve nga Kuvendi i Kosovës, FSK-ja do të shndërrohet në ushtri, por që vetëm emrin nuk do ta ketë të tillë?

Berisha: Realisht Forca e

Sigurisë së Kosovës do të ketë kompetenca dhe detyra të reja që përcaktohen me ligj, edhe MFSK-ja do të kalojë në Ministri të Mbrojtjes. Kurse, emri do të ndryshohet sapo të krijohen rrethanat më të përshtatshme për ndryshime kushtetuese.

"Epoka e re": Prisni që deri në fund të vitit Kuvendi t'i miratojë këto tri projektligje?

Berisha: Nuk e dimë saktë se kur do të ndodhë një gjë e tillë, meqë në Kuvend ka edhe projektligje të tjera që janë në pritje të miratimit. Ne kemi kryer punën tonë dhe tani është në dorën e Qeverisë t'i procedojë më tutje këto projektligje.

"Epoka e re": Deri më tani kemi pasur kundërshtimin e Listës Serbe për transformimin e FSK-së. Keni biseduar me ata për t'i mbështetur këto projektligje, pra keni mbështetur edhe të këtij partneri qeverisës?

Berisha: Paraprakisht, para se këto projektligje të shkojnë në Kuvend, do të kemi takime me të gjitha grupet parlamentare, edhe me grupin parlamentar të Listës Serbe për t'i njoftuar të

gjithë me këto tri projektligje.

"Epoka e re": Nuk prisni pengesa në këtë drejtim me që për miratimin e projektligjeve kërkohet një shumicë e thjeshtë?

Berisha: Nuk ishte dashur të ndodhë një gjë e tillë, por kjo pyetje më mirë do të ishte që t'u drejtohet atyre. Ne në kuadër të planit tonë të punës kemi paraparë edhe takimet me grupet parlamentare dhe realisht të marrim sugjerime shtesë nëse ka nevojë dhe ato të bëhen gjatë shqyrtimit të parë dhe të dytë të këtyre projektligjeve.

"Epoka e re": Iniciativa për miratimin e këtyre tri projektligjeve është bërë në koordinim me partnerët strategjikë siç janë NATO-ja, BE-ja dhe ShBA-ja, sepse në vazhdimësi partnerët ndërkombëtarë kanë kundërshtuar procesin e transformimit të FSK-së nëpërmjet ligjit.

Berisha: Kemi ndërmarrë një fushatë informuese me të gjitha shtetet partnere, shtetet e Quintit dhe shtetet e NATO-s, të cilat i kemi njoftuar për gatishmërinë tonë, për progresin, për të arriturat dhe i kemi njoftuar

petenca të reja për FSK-në



edhe për mundësinë ose rrugën se si ne parashohim të lëvizim. Kështu që, gjithçka që është bërë deri më tani është bërë në bashkëpunim dhe kemi qenë transparentë edhe në raport me partnerët tanë ndërkombëtarë.

"Epoka e re": Pra, Kosova ka siguruar mbështetjen e partnerëve ndërkombëtarë për të lëvizur më tutje në procesin e transformimit të FSK-së përmes ligjit?

Berisha: Është problem të themi se e kemi mbështetjen sepse e dimë që në mesin e shteteve të NATO-s janë katër shtete që ende nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës, por ne punën tonë e kemi kryer dhe nuk i kemi sjellë në situatë që ata të befasohen për një hap të tillë, sepse i kemi njoftuar me rrugën përpara. Kjo nuk duhet të merret si shqetësuese sepse është një hap që ne po fillojmë planin e transformimit që është paraparë të jetë dhjetë vjet dhe në ndërkohë, kur të krijohen kushtet dhe rrethanat më të përshtatshme, do të ndërmarrim veprime që ta ndryshojmë edhe emrin përmes ndryshimeve kushtetuese. E kemi kryer punën dhe obligimin tonë. Tani mbetet që projektligjet të procedohen për Kuvend. Shpresojmë që votimi i këtyre projektligjeve nuk do të jetë ndonjë vështirësi. Është me rëndësi të kuptohet se asnjëra prej këtyre tri projektligjeve nuk është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, përkundrazi janë në harmoni të plotë.

"Epoka e re": Sa do të jetë sfidues ky proces për ju si ministër, por edhe për Kosovën?

Berisha: Ky është një lajm i mirë për të gjithë. Është obligim kushtetues yni që t'i ndërtojmë ose t'i ngrehim institucionet e sigurisë dhe ta avancojmë strukturën e sigurisë për kryerjen e kompetencave dhe detyrave që parashihen me Kushtetutë. Kjo nuk ka të bëjë me dëshirën ose me vullnetin, por është obligim kushtetues që të ndërmarrim masa të tilla. Ne nuk dëshirojmë të jemi vetëm konsumues të sigurisë, por të jemi edhe kontribuues aktivë të saj. Edhe me kapacitetet aktuale, por edhe me kapacitetet e tjera që do t'i ngrehim, do të jemi kontribuues të paqes dhe të sigurisë. FSK-ja do të jetë forcë shumetnike dhe profesionale në shërbim të gjithë qytetarëve dhe në interes të tyre dhe vendit, por edhe më gjerë në rajon.

"Epoka e re": Po thoni se FSK-ja do të vazhdojë të jetë forcë shumetnike, por më herët ka pasur largime të pjesëtarëve të saj të komunitetit serb.

Berisha: Na vjen keq që disa pjesëtarë të FSK-së nga komuniteti serb kanë qenë të detyruar që, pa vullnetin e tyre, të marrin vendim për largimin nga FSK-ja. I kuptojmë se kanë pasur presione të ndryshme dhe është vendim kundër mirëqenies së tyre. I kemi shqyrtuar shumicën prej kërkesave të tyre, për disa edhe i kemi marrë vendimet, kurse disa të tjera janë në shqyrtim. Por, mund të them se është një interesim i jashtëzakonshëm i komunitetit serb që të bashkëngjitet në FSK dhe të plotësohen ato vende të punës.

Veseli u bënë thirrje për unitet pozitiv dhe opozitës për votimin e projektligjeve

PRISHTINË, 13 SHTATOR (ER) - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka bërë me dije të enjten se vazhdimi i seancës plenare do të mbahet sot (e premte) në orën 11:00. Ai ka bërë thirrje që të ketë unitet në mes të pozitës dhe opozitës për projektligjet që kanë të bëjnë me procesin integruar të Kosovës. "Të nderuar kolegë deputetë, tani neve na mbesin detyrat tona për përmbushjen e ligjeve që janë vetëm në këtë rend dite. Pra, janë disa projektligje që ndërliken drejtpërdrejt me partneritetin e Bashkimit Evropian me Kosovën. Janë edhe disa ndihma dhjetëramilionëshe që BE-ja jep për qytetarët tanë. Pa dallim, pozitë dhe opozitë, ftoj edhe kolegët nga opozita të jenë bashkë me ne që të marrim vendime për interesa të

qytetarëve", ka thënë Veseli. Edhe ministrja e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka ftuar deputetët ta rikonfirmojnë unitetin, duke miratuar dy projektligje të rëndësishme për procesin integruar. Projektligjet që pritet të votohen janë: Projektligji për ratifikimin e Marrëveshjes financiare IPA 2017, pjesa e parë, ndërmjet Kosovës dhe BE-së; Marrëveshja ndërmjet Kosovës dhe BE-së për pjesëmarrjen e Kosovës në programin "Evropa për qytetarët", vlera e marrëveshjes së parë është 48 milionë euro, ndërsa e dyta përmban fonde me vlerë 187 milionë euro. Sipas ministres Hoxha, miratimi i këtyre dy projektligjeve i mundëson Kosovës qasje të menjëhershme në programe të dobishme për shumë fusha me rëndësi.



Sondazhi: Një vit pas, qytetarët të pakënaqur me punën e ekzekutivit dhe të legjislativit

Eugen Cakolli nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka bërë me dije se 74 për qind e të anketuarve mendojnë se gjërat në Kosovë janë duke shkuar në drejtimin e gabuar. Sipas rezultateve të hulumtimit të KDI-së, 72 për qind e qytetarëve janë të pakënaqur me punën e Qeverisë, kurse 72 për qind e tyre janë deklaruar të pakënaqur me punën e Kuvendit



EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 13 SHTATOR - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka bërë të enjten prezantimin e gjetjeve nga hulumtimi për matjen e opinionit publik në Kosovë lidhur me gjendjen aktuale politike, kënaqshmërinë me punën e institucioneve publike, si dhe preferencat politike të qytetarëve për zgjedhjet e ardhshme. Sipas këtij instituti, subjekti politik i cili do të votohej më së shumti nga qytetarët, nëse zgjedhjet do të mbaheshin këtë të diel, del të jetë Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me 23.8 për qind, e ndjekur nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me 18.4 për qind, Lëvizja Vetëvendosje (LV) me 17.6 për qind dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) me 8.8 për qind të të anketuarve. 4.1 për qind e qytetarëve të anketuar kanë deklaruar se do të votonin për Listën Serbe.

Nisma Socialdemokrate, sipas këtij sondazhi, do të merrte 4.9

për qind të votave, Partia Socialdemokrate 2 për qind, Aleanca Kosova e Re 1.7 për qind dhe Alternativa 0.6 për qind. Kjo nënkupton se këto parti nuk do të mund ta kalonin pragun zgjedhor prej 5 për qindësh.

Eugen Cakolli nga KDI-ja ka shtuar se 15.6 për qind e të anketuarve kanë refuzuar të deklarojnë se për cilin subjekt do të votonin. Në fund, të anketuarit që kanë deklaruar se për cilin subjekt politik do të votonin në zgjedhjet e ardhshme janë pyetur edhe lidhur me koalicionet e mundshme mes atij subjekti dhe subjekteve të tjera.

Trendët e përgjithshëm të këtyre rezultateve tregojnë se shumica e elektoratit në Kosovë preferon që subjektet e tyre të garojnë të vetme në zgjedhje. Të ndarë sipas secilit subjekt politik, këto janë preferencat e votuesve lidhur me koalicionet, të paraqitura në për qindje kumulative: Votuesit e LDK-së do ta preferonin më së shumti një koalicion me LV-në (27 për qind), kurse janë më së

shumti kundër një koalicioni me PSD-në (60 për qind); Votuesit e PDK-së do ta preferonin më së shumti një koalicion me PSD-në (25 për qind), kurse janë më së shumti kundër një koalicioni me LV-në (86 për qind); Votuesit e LV-së do ta preferonin më së shumti një koalicion me LDK-në (33 për qind), kurse janë më së shumti kundër një koalicioni me PDK-në (61 për qind); Votuesit e PSD-së do ta preferonin më së shumti një koalicion me AAK-në (13 për qind), kurse janë më së shumti kundër një koalicioni me LV-në (65 për qind); Votuesit e AAK-së

do ta preferonin më së shumti një koalicion me Nismën (28 për qind), kurse janë më së shumti kundër një koalicioni me LDK-në (66 për qind); Votuesit e Nismës Socialdemokrate do ta preferonin më së shumti një koalicion me PDK-në (16 për qind), kurse janë më së shumti kundër një koalicioni me LV-në (70 për qind). Po ashtu, Eugen Cakolli ka theksuar se rezultatet e këtij sondazhi tregojnë se 74 për qind e të anketuarve mendojnë se gjërat në Kosovë janë duke shkuar në drejtimin e gabuar. "Po ashtu, qytetarët janë pyetur konkretisht për

kënaqshmërinë e tyre me punën e Qeverisë së Kosovës. Sipas rezultateve të hulumtimit, 72 për qind e qytetarëve janë të pakënaqur me punën e Qeverisë, ndërsa vetëm 26 për qind janë deklaruar të kënaqur me punën e saj", ka bërë me dije ai.

Në kuadër të këtij hulumtimi, Cakolli ka thënë se qytetarët janë pyetur edhe për kënaqshmërinë e tyre me punën e Kuvendit të Kosovës. Vetëm 26 për qind e të anketuarve janë deklaruar të kënaqur me punën e Kuvendit, kurse 72 për qind e tyre janë deklaruar të pakënaqur.

Nga 1 nëntori përformuesit e kulturës dhe punëtorët profesionalë do t'i marrin pagat me rritje

EPOKA E RE Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 13 SHTATOR - Në mbledhjen e Qeverisë të enjten është miratuar koncept-dokumenti për gradimin dhe pagat e krijuesve dhe përformuesve të kulturës dhe të punonjësve profesionalë të trashëgimisë kulturore. Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, në ekspozitën e tij ka treguar se koncept-dokumenti ka për qëllim krijimin dhe zhvillimin e politikave kulturore, ambientin dhe mekanizmat e përshtatshëm për promovimin e kulturës, e cila konsiderohet një prej çështjeve më të rëndësishme.

Në këtë kuadër, koncept-dokumenti parasheh mbështetjen e kapaciteteve njerëzore në fushën e kulturës dhe trashëgimisë kulturore, sigurimin e një trajtimi të dinjitetshëm dhe meritore për këtë kategori të rëndësishme të shoqërisë, me qëllim të ngritjes së performancës institucionale dhe pasurimit të jetës kulturore dhe

mbrojtjes së trashëgimisë kulturore në vendin tonë. "Pagat dhe gradimi i punonjësve të kulturës dhe të trashëgimisë kulturore janë rregulluar me Rregulloren nr. 05/2011 për gradimin dhe pagat e krijuesve dhe përformuesve të kulturës dhe punonjësve profesionalë të trashëgimisë kulturore, rregullore kjo e cila ka bërë një rregullim adekuat dhe meritore, por me kalimin e kohës janë hasur probleme me çështjen e gradimit të punonjësve të fushës së kulturës dhe të trashëgimisë kulturore në lidhje me gradat joadekuate; statusi dhe pozicionimi joadekuat profesional; problemi i pagave të ulëta jokonkurrese me rajonin; dhe trajtimi i pabarabartë i punonjësve brenda institucioneve", ka thënë ministri Gashi, duke shtuar se me sigurimin e një page bazë konkurruese me rajonin do të kontribuojmë në konkurrencë dhe interesim më të madh të punëtorëve profesionalë të kulturës për angazhim në institucionet publike të kulturës dhe të trashëgimisë kulturore. "Me miratimin e Rregullore



kemi dhënë përgjigjen e duhur dhe meritore për çështjet e sistematizimit të pagave, gradimit dhe kategorizimit të krijuesve, përformuesve të kulturës dhe

punonjësve të trashëgimisë kulturore. Me këtë rregullore kemi krijuar parakushtet për t'i arritur objektivat e përcaktuara në politikën programore për kulturë e

trashëgimi kulturore", ka thënë ministri Gashi. Ai i ka uruar të gjithë krijuesit, përformuesit dhe punonjësit e trashëgimisë kulturore rritjen e pagave.

Qeveria e Kosovës ka mbajtur mbledhjen e radhës

Qeveria miraton pakon e projektligjeve për mandatin e FSK-së

Qeveria e Kosovës në mbledhjen e së enjtes ka miratuar pakon e projektligjeve që rregullojnë rolin, funksionin dhe shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës. Kjo pako përfshin Projektligjin për Forcën e Sigurisë së Kosovës, Projektligjin për shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Projektligjin për Ministrinë e Mbrojtjes. Kryeministri Ramush Haradinaj ka bërë me dije se Kosova do të ndërtojë një forcë të armatosur, profesionale, shumetnike dhe gjithëpërfshirëse, të rreshtuar me ushtritë e paqes, bazuar në standardet e NATO-s



Kosovës, Hashim Thaçi, kishte dërguar në Kuvend një ligj nëpërmjet të cilit mëtohej të shndërrohej FSK-ja në ushtri. Por, ky ligj ishte tërhequr, me argumentimin se do të tentohej që ky transformim të bëhet përmes ndryshimeve kushtetuese. Lista Serbe, parti e përfaqësuar në Kuvendin e Kosovës, në vazhdimësi ka kundërshtuar shndërrimin e FSK-së në Forcë të Armatosura nëpërmjet ndryshimeve kushtetuese.

Thaçi: Qeveria ta procedojë në Kuvend Projektligjin për ushtrinë

Pas miratimit të projektligjeve që rregullojnë rolin, funksionin

jektligj nuk mund të jetë i befasuar askush, pasi për të kanë qenë të përgatitur e të njoftuar të gjithë në vazhdimësi. "Kosova nuk mund të vazhdojë pa i marrë përgjegjësitë e veta. Parlamenti është institucioni i radhës që do ta trajtojë atë. Deputetët e kanë mundësinë ta japin mendimin e tyre. I ftoj të gjithë ta votojnë", ka thënë Haradinaj.

Ai ka shtuar se kompletimi i mekanizmave të sigurisë është investimi më i madh i vendit tonë në të ardhmen e sigurt. "Kosova do të ndërtojë një forcë të armatosur, profesionale, shumetnike dhe gjithëpërfshirëse, të rreshtuar me ushtritë e paqes, bazuar në standardet e NATO-s. Në këtë rrugëtim tonin do të jemi shumë të kujdesshëm që secili hap që ka të bëjë me ushtrinë e Kosovës të bëhet në pajtim me aleatët tanë strategjikë në NATO, posaçërisht me ShBA-në", ka thënë Haradinaj.

Vitin e kaluar presidenti i



EPOKA
ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 13 SHTATOR - Qeveria e Kosovës, bazuar në të drejtën kushtetuese, ka miratuar të enjten pakon e projektligjeve që rregullojnë rolin, funksionin dhe shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës. Në këtë kuadër është miratuar Projektligji për Forcën e Sigurisë së Kosovës, Projektligji për shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Projektligji për Ministrinë e Mbrojtjes. Projektligji për Forcën e Sigurisë së Kosovës përcakton kompetencat, organizimin dhe funksionimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës si forcë shumetnike, profesionale, e armatosur dhe e autorizuar për të shërbyer në vend dhe jashtë vendit në pajtim me mandatin e dhënë kushtetues dhe ligjor, në mbrojtje të integritetit territorial, të qytetarëve, të pronës dhe interesave të Republikës së Kosovës dhe e cila i nënshtrohet kontrollit civil demokratik.

Projektligji për Shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës rregullon kushtet e përgjithshme të shërbimit në Forcën e Sigurisë së Kosovës si një shërbim i ndërtuar mbi bazën e parimit të ligjshmërisë, profesionalizmit, komandës, disiplinës, respektit, nderit, ruajtjes së informacionit, komunikimit, josediskriminimit dhe mundësive të barabarta, paanshmërisë politike, transparencës dhe llogaridhënies.

Projektligji për Ministrinë e Mbrojtjes përcakton organizimin dhe kalimin e Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës në Ministri të Mbrojtjes në kuadër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me qëllim të mbikëqyrjes dhe kontrollit civil demokratik mbi Forcën e Sigurisë së Kosovës, me strukturën e saj organizative që siguron funksionalizimin e plotë dhe përmbushjen e përgjegjësisë së saj.

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, në një konferencë për media ka thënë se me këtë pro-

Ambasada e ShBA-së: Kosova nuk u konsultua me ne për FSK-në

Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Kosovë ka reaguar pas miratimit të projektligjeve nga Qeveria që rregullojnë rolin, funksionin dhe shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës. Përmes një reagimi për medie Ambasada e ShBA-së në Kosovë ka theksuar se mbështet të drejtën sovranë të Kosovës për ushtri, por thuhet se nuk janë këshilluar paraprakisht për këtë vendim të Qeverisë. "Shtetet e Bashkuara të Amerikës gjithmonë e kanë mbështetur të drejtën sovranë të Kosovës për ushtri dhe kanë punuar ngushtë me Kosovën rreth mënyrës për ta arritur këtë. Ne kemi këshilluar një

qasje të matur që e mban Kosovën në përputhje me aleatët tanë në NATO për këtë hap të rëndësishëm. Nuk jemi këshilluar për çastin e këtij lajmërimi dhe do të na duhet t'i analizojmë projektligjet për ta kuptuar qëllimin dhe efektin e tyre. Përpjekjet tona të disa javëve të shkuara janë përqendruar në ndërtimin e konsensusit të brendshëm për dialogun e rëndësishëm me Serbinë. Vazhdojmë të besojmë se normalizimi ndërmjet Kosovës dhe Serbisë është hapi më i rëndësishëm për përparim në të ardhmen e afërt", është thënë në komunikatën e ambasadës së ShBA-së në Kosovë.

dhe shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës, presidenti Hashim Thaçi ka thënë se Kosova duhet ta ketë ushtrinë e vet. Ai ka thënë se për shkak të interesave të ngushta, ndonjëherë elektorale dhe ndonjëherë tjetër ideologjike, lider-shipi në Kosovë e ka vonuar transformimin e Forcës së Sigurisë në Forcë të Armatosura të Kosovës. "Unë vazhdimisht kam qenë i vetëdijshëm në këtë pikë. Kosova duhet ta ketë ushtrinë e vet. Me iniciativën time si president kemi ndërmarrë një fushatë vetëdijesimi, brenda dhe jashtë Kosovës, për t'i sensibilizuar miqtë tanë për rëndësinë e këtij procesi. Aleatët tanë e dinë që ky proces duhet të përmbillet pa vonesa. Po ashtu, e kemi bërë të qartë që askush, asnjë faktor i jashtëm, nuk mund të ketë veto në shtetndër-

timin tonë", ka deklaruar Thaçi, duke shtuar se është pro transformimit të Forcës së Sigurisë në Forcë të Armatosura të Kosovës. Ai ka pohuar se Ushtria e Kosovës nuk është kërcënim për rajonin. "Përkundrazi, do të jetë në shërbim të ruajtjes së paqes, sigurisë shtetërore, rajonale dhe globale. Prandaj, në këtë pikë institucionet e Kosovës flasin me një zë dhe kemi një qëndrim. Ligji i miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës duhet të procedohet edhe në Kuvend dhe periudha deri në miratimin e tij duhet të shfrytëzohet nga të gjithë ne për t'i bindur skeptikët e mbetur të këtij procesi. Jam i bindur se në koordinim të plotë me ShBA-në dhe aleatët tanë në NATO do ta përmbylim këtë proces të vonuar, por jetik për Kosovën", ka thënë presidenti Thaçi.

(Lexim analitik i fjalimit në Mitrovicë të presidentit serb)

Logjika e Millosheviqit në mendjen politike të Aleksandër Vuçiqit



Dr. Sabri KIÇMARI

Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, në fjalimin e tij në Mitrovicë, më 9 shtator 2018, ka demonstruar mendësinë nacionaliste agresive, identike me ato që kishte bërë Slobodan Millosheviq në vitin 1989 në Fushë-Kosovë dhe Vladimir Putini në mars të vitit 2015 në Dumën Ruse, pas pushtimit të Krimesë.

Edhe pse fjalimi ishte menduar si një bashkëbisedim me qytetarët serbë të Kosovës, janë tri subjekte kryesore të cilave u adresohet Aleksandër Vuçiqi: qytetarëve serbë të Kosovës, opozitës në Serbi dhe aktorëve ndërkombëtarë. Dhe varësisht nga subjekti, që i adresohet, ndryshojnë edhe mesazhet, në përmbajtje herëherë kontradiktore.

Fjalimin e përshkon një fill i kuq nacionalizmi serbomadh. Vuçiqi flet për "Serbinë e Madhe", për Betejën e Kosovës, e cilëson Millosheviqin si "lider të madh serb, i cili kishte qëllime madhështore", flet me përçmim racist për shqiptarët, hyjnizon "tri e më shumë luftëra, që serbët kanë zhvilluar në shekullin e kaluar, në të cilat serbët kanë vdekur në Knin (Kroaci), Sarajevë (Bosnje) dhe Prishtinë (Kosovë)". Por, ajo që nuk përmendi Vuçiqi janë viktimat, gjenocidi, terrori masiv, pastrimi etnik, dhunimet dhe vrasjet, që gjatë këtyre luftërave i kanë shkaktuar forcat ushtarake serbe.

Gjuha raciste ndaj shqiptarëve shfaqet hapur, sidomos kur flet në mënyrë përçmuese për z. Thaçi: "Hashim Thaçi quhet ai njeri, atje. Po, po, shqiptar është... dhe unë duhet të flas me të". Me këtë adresim ai ripërsërit në fjalorin politik serb simbolikën e shqiptarit, për të cilin logjika nacionaliste serbe mendon se nuk është i denjë për të biseduar më të, por vetëm për ta sunduar, burgosur dhe vrarë. Të njëjtën gjë bëjnë me fyerjen e flamurit kroat, kur deklaroi se në "Knin valon fusha e shahut, e cila nuk ka qenë kurrë atje".

Mendësia kolonialiste shprehet edhe në fjalinë, në të cilën

i kritikon serbët se e kanë mohuar mësimin e gjuhës shqipe me përbuzje, përderisa shqiptarët e mësonin gjuhën serbe. Ai i kritikon shqiptarët tani se po bëjnë të njëjtin gabim si edhe serbët dikur, pasi që nuk po e mësojnë më gjuhën serbe. Sigurisht ai dëshiron që shqiptarët ende në Kosovë të mësonin serbishten dhe jo anglishten e gjermanishten, porse "harroi", me këtë rast, të ftoj pakicën serbe të mësojë gjuhën shqipe, për t'u gjendur dhe integruar më lehtë në shoqërinë e Kosovës.

Vuçiqi në fjalimin e tij e ka cilësuar luftën e Serbisë kundër NATO-s në vitin 1999 si një luftë "të vërtetë dhe trimërore", të cilën e ka humbur "si 610 vite më parë".

Pasi që serbët e kanë humbur luftën, ata kanë humbur territore të rëndësishme, kanë lënë shtëpitë dhe vendbanimet e tyre, duke mos dashur të jetojnë nën qeverisjen e shqiptarëve. Komenti i tij i thjeshtë: "Kur të humbni luftën, për këtë paguhet çmimi. I lartë, më i lartë".

Madhërimi i figurës së Millosheviqit si "një lider i madh serb me qëllime shumë të mira" dëshmon se logjika e Millosheviqit është ulur këmbëkryq në mendjen politike të Aleksandër Vuçiqit. Serbia nuk u bë e madhe për shkak të analizës së dobët të Millosheviqit dhe jo për shkak se kjo ide ishte e padrejtë. Pikërisht këtu shpërfaqet lakuriq mendimi i tij themelor nationalist serbomadh. Shpresoj se BE-ja dhe SHBA-të do ta lexojnë me kujdes këtë gjë. Dhe të kuptojnë se ushtrimet e përbashkëta ushtarake të ushtrisë serbe me atë ruse dhe bjelloruse, nuk janë vetëm një simbolikë distancë ndaj NATO-s, por janë orientimi i tyre strategjik ushtarak. Jo pa qëllim ai sërish falënderoi Moskën për mbështetjen e Serbisë, tha se Serbia nuk dëshiron të anëtarësohet në NATO, me qëllim të mbrojtjes së pavarësisë dhe neutralitetit. Por, Serbia në rrafshin ushtarak nuk është as e pavarur dhe as neutrale. Ushtrimet ushtarake me Rusinë dhe Bjellorinë dëshmojnë se partner të tyre janë këto dy vende me qeverisje autokratike. BE-ja duhet ta sqarojë këtë diskrepancë të pakalueshme për kulturën demokratike: a mund të pranohet në BE një vend që orga-

nizon ushtrime ushtarake të përbashkëta me Rusinë dhe Bjellorinë, lejon hapjen e misioneve ushtarake të kundërzbulimit rus në Nish dhe blen armatime të rënda nga Rusia.

Por, ka edhe një element interesant në fjalimin e Vuçiqit: realizmi i tij. Ai e pranon se Serbia përmes luftës ka humbur shumë: në Kroaci, por edhe në Sarajevë dhe Prishtinë numri i serbëve ka rënë ndjeshëm. Ai e pranon se rezultati i politikës së Millosheviqit në Kosovë ka qenë fatal: qenë kthyer vetëm disa mijëra familje në Kosovë, kurse kanë ikur qindra mijëra. Dhe për këtë gjë ai e fajëson Serbinë, e cila nuk e ka kuptuar realisht pozitën e saj në botë, se nuk e ka kuptuar se serbët nuk janë të vetmit në botë, se e kanë dëgjuar vetëm veten e tyre. Dhe për këtë serbët e kanë paguar çmimin më të madh. Ai konstaton se populli serb është bilogjikisht para ambisit, është në buzë të humnerës, dhe ka diçka që e tërheqë për të bërë një hap teposhtë, se shekulli i njëzetë i ka vrarë serbët, se Serbia ka humbur shumë njerëz, të cilët nuk do të zëvendësohen as në shekullin e ri. Prandaj i thërret njerëzit të kuptojnë se mundësia është që "të fitohet diçka, e cila do të mundësojë që Serbia të jetë një vend normal me jetë normale". Ai thotë se nuk dëshiron që t'i ftojë serbët të realizojnë Serbinë e Madhe "me çizme dhe me pushkë në dorë", por me "libër, laptop. Me punë dhe dije".

Në akord me planin e tij për t'u paraqitur paqësor Vuçiqi tha se nuk dëshiron të dëgjojë këngë luftarake dhe t'ju pretoj armë serbëve, siç kishte bërë ai në vitet '90-ta bashkë me Millosheviqin dhe Sheshelin, por në të njëjtën kohë i siguroi serbët se nuk do të lejojë që të tjerët të përdorin armë dhe municione kundër tyre. Edhe pse në dukje një fjali e tillë ishte paqësore, në përmbajtjen e saj kishte element nxitës: la përshtypjen sikur dikush dëshiron që kundër serbëve të përdorë armët.

Adresimin kundër oponentëve të tij politikë në Serbi presidenti serb e bëri duke i akuzuar ata "për dorëzimin në Tribunalin e Hagës të ish-presidentit të Serbisë Millosheviq dhe të gjeneralëve ushtarakë e policorë serbë". Ai thotë se pikërisht ata sot po mbajnë leksione patriotike. Ai konsta-

toi se ata e nxorën çështjen e Kosovës nga formati i OKB-së për ta dërguar atë në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë, duke shpresuar se me këtë do t'i siguronin vetes pushtetin, por me këtë serbët morën "përgjigjen më të keqe të mundshme. Për këtë po paguhet një çmim i lartë".

Dëgjuesi i vëmendshëm do të mësojë se strategjia serbe për të realizuar interesat e Serbisë në Kosovë ka tri elemente kryesore: rrugën diplomatike në raport me ndërkombëtarët, dialogun me shqiptarët e Kosovës dhe investimet ekonomike të Serbisë në Kosovë. Plani i drejtpërdrejtë i investimeve të shtetit serb (rreth 71 milionë euro në vit) në zonat e banuara me serbë në Kosovë jo vetëm për pagat, por edhe në fushën e shëndetësisë, arsimit dhe atë ekonomike e sociale dëshmon për një prezencë mirë të planifikuar, e cila mund të rezultojë me efekte konkrete.

Në fund të fjalimit të tij Vuçiqi ju rikthye sërish retorikës nacionaliste, duke u thënë serbëve të mbledhur se ata kanë humbur të gjitha, kanë sakrifikuar për Serbinë dhe për serbët. Ai u thotë atyre se i duhen të gjithë ende Serbisë, për "një përpjekje të re për të ardhmen". Ai provon të ngjallë shpresën te ata se ai ka për qëllim, që Serbia të fitojë, për herë të parë pas shumë vitesh, pa gjak, pa vdekje, pa tmerre dhe varre, "për ta bërë Serbinë e Madhe duke pushtuar të ardhmen".

Aleksandër Vuçiqi nuk demonstroi vullnetin për paqe gjatë vizitës së tij në Kosovë. Ai mund ta bënte këtë: të mos kërkonte të shkonte në Banjë, por në Prekaz dhe Reçak. Të përkulej para varreve të fëmijëve, grave dhe pleqve dhe të kërkonte falje para popullit të Kosovës për krimet e shtetit serb. Thjeshtë, të bënte atë që pati bërë kancelari gjerman Vili Brandt në vitin 1970 në Varshavë. Por, Vuçiqi dhe mendësia e tij nacionaliste nuk e përballon këtë gjë.

Se qëndrimi i tij në lidhje me Kosovën nuk ka ndryshuar shprehet në sigurinë drejtuar serbëve "se janë gënjeshtër ato që thuhet se ai do të njoh Republikën e Kosovës deri në fund të vitit", duke e quajtur këtë "një rrenë e pabesueshme, e cila askujt prej nesh nuk i shkon në mendje". Ai provokoi sërish duke thënë se "Rruga Oliver

Ivanoviq në Mitrovicën e Kosovës do të bëhet më e bukura ... sepse populli dhe shteti serb e kanë vendosur këtë". Pra, sërish dëshmoi se këtë pjesë ai e konsideron pjesë të shteti të tij, duke betonuar qëndrimin për ndarjen e Kosovës, me kufirin te muri i Mitrovicës, në të cilin shkruan "Nga këtu nuk ka kthim mbrapa!"

Nga fjalimi i presidentit serb në Mitrovicë mund të nxirren tri përfundime themelore:

1. Aleksandër Vuçiq nuk ka hequr dorë nga programi i Millosheviqit: ai nuk do ta njohë Kosovën, do të punojë në krijimin e Serbisë së Madhe, në të cilën të gjithë serbët do të jetojnë në një shtet, por këtë gjë, ndryshe nga Millosheviq, synon ta arrijë në rrugë tjetër: pa luftë, me diplomaci dhe me mbështetjen e ndërkombëtarëve. Pra, thjeshtë, Vuçiqi synon ta arrijë në paqe, atë që Serbia e ka humbur në luftë: të realizojë ëndrrën e Slobodan Millosheviqit. Ai tregohet i vendosur të punojë në këtë drejtim "pavarësisht çmimit", pavarësisht akuzave për "tradhtar ose shovinist serb", duke thënë se ai e dallon mirë "patriotizmin e salloneve dhe atij të vërtetë".

2. Serbia në rrafshin ushtarak nuk është vend neutral: ajo është në aleancë me Rusinë dhe Bjellorinë. BE-ja do të duhej të analizojë me kujdes nëse vërtetë e ka të mundur ta pranojë Serbinë në radhët e saj, pa e detyruar atë të krijojë distancën ushtarake me Rusinë dhe Bjellorinë. Vlerat agresive kundër vendeve fqinje, që janë në themel të kësaj aleance, janë në kundërshtim me vlerat e paqes dhe sigurisë në Evropë që synon BE dhe NATO.

3. Kosova duhet të regjistrojë faktin se strategjia serbe e veprimit ka zbritur në terrenin diplomatik. Po investon dhe po noton në mes të Lindjes dhe Perëndimit, duke luajtur herë me kartën e paqes dhe herë atë të kërcënimit. Në Mitrovicë u dëshmuar se qëllimi i Vuçiqit nuk dallon nga ai i Millosheviqit. Vetëm format e veprimit kanë ndryshuar. Ai nuk është njeri i paqes, por dëshiron të përfitojë nga pagja, e cila u është imponuar serbëve pas agresionit kundër vendeve fqinje. Në përputhje me këtë fakt, politika jonë e jashtme duhet të ndërtojë strategjinë e veprimit.

Rritja ekonomike që nuk po sjell ndryshim

PRISHTINË, 13 SHTATOR - Autoritetet vendore dhe ato ndërkombëtare prezantojnë shifra të ndryshme në lidhje me shkallën e rritjes ekonomike në Kosovë gjatë këtij viti.

Banka Botërore në raportin e fundit për ekonominë në Ballkanin Perëndimor veçon se rritja ekonomike në Kosovë për vitet 2018-2020 parashihet të arrijë në 4.8 për qind. Ndërsa parashikimet e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës parashikojnë që norma reale e rritjes ekonomike do të luhet në një interval prej 4.2 deri në 4.4 për qind. Por, pavarësisht prej shifrave, ekspertë për çështje ekonomike dhe përfaqësues të komunitetit të biznesit theksojnë se kjo rritje është e pamjaftueshme në aspektin e zhvillimit afatgjatë të Kosovës.

Në termat ekonomike, rritja ekonomike është rritje e prodhimit, kapaciteteve prodhuese dhe të gjithë përbërësve të tjerë të një ekonomie. Po ashtu, rritja ekonomike vjen për shkak

të rritjes së fuqisë punëtore ose kapitalit.

Muhamet Mustafa, këshilltar i lartë në Institutin për Hulumtime Zhvillimore "RIINVEST", thotë se vitet e fundit ka pasur trend të rritjes, por dyshon se ky nivel i rritjes ekonomike mund të përmirësohet gjatë këtij viti për shkak të situatës aktuale politike. "Frikësohem se nuk do mundësohet rritje më e madhe. Në rend të parë, për shkak të një aktiviteti investiv, pasi ka shenja se investimet e huaja janë në rënie e, gjithashtu, edhe investimet vendore nuk janë në dinamikën e duhur. Në ekonomi, një rëndësi shumë të madhe e kanë pritjet e konsumatorëve dhe pritjet e bizneseve lidhur me situatën ekonomike lidhur me stabilitetin politik dhe ekonomik", ka theksuar Mustafa për "Radion Evropa e Lirë".

Edhe drejtori ekzekutiv i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, Arian Zeka, ka thënë se është inkurajues fakti se Kosova që nga shpallja e pavarësisë në



vitin 2008 ka pasur nivel më të lartë të rritjes ekonomike. Madje vitin e kaluar norma e rritjes ekonomike në Kosovë ka qenë më e lartë krahasuar me vendet e rajonit. Por, sipas tij, në ekonom-

inë e Kosovës ka qenë e padukshme kjo rritje për shkak se Kosova ka bazën më të ulët nga kalkulohet rritja ekonomike. Në një raport të Bankës Botërore, të publikuar vitin e kaluar, është

thënë se vendeve të Ballkanit Perëndimor, përfshirë edhe Kosovën, do t'u duhen deri në gjashtë dekada në mënyrë që nivelet e të ardhurave t'i kapin ato të Bashkimit Evropian.

Matoshi merr përkrahje nga KFOR-i për aksionin 'Ta pastrojmë Kosovën'

PRISHTINË, 13 SHTATOR - Në prag të fillimit të aksionit "Ta pastrojmë Kosovën", ushtruesi i detyrës së ministrit të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), Fatmir Matoshi, ka pritur në takim gjeneralin e Brigadës John C. Boyd, shef i shtabit të KFOR-it në Kosovë. Matoshi gjatë këtij takimi ka treguar për përgatitjet e MMPH-së për aksionin e pastrimit të vendit, duke thënë se synim kryesor është pastrimi i brezave rrugore, pikave kufitare dhe brezave rreth lumenjve. "Mbështetja e KFOR-it gjatë këtyre tre muajve të aksionit është shumë e rëndësishme, andaj prania e KFOR-it



do të ishte shumë e mirëseardhur, për të qenë më afër njerëzve dhe komunave në Kosovë, duke përfshirë edhe ato

veriore. Ne e duam një mjedis të pastër në tërë Republikën e Kosovës", ka thënë Matoshi. Më tutje Matoshi ka kërkuar

nga KFOR-i që gjatë tre muajve të aksionit ta pastrojmë Kosovën të bëhet një sensibilizim dhe njoftim për qytetarët

për rrezikun eventual nga mjetet e dyshimta shpërthyes nëse hasen gjatë aksionit.

Ndërsa gjeneral brigade John C. Boyd, shef i shtabit të KFOR-it, ka shprehur gatishmërinë për t'iu bashkëngjitur aksionit të 15 shtatorit. Ai ka thënë se KFOR-i do të jetë në dispozicion të qytetarëve dhe të komunave në rast se hasin në mjete të dyshimta gjatë këtij aksioni, ndërsa ka treguar se KFOR-i shumë shpejt do ta publikojë një video sensibilizuese për këtë dukuri.

Aksioni "Ta pastrojmë Kosovën" do të fillojë më 15 shtator, për të përfunduar më 15 dhjetor 2018.

ASK-ja: Qeveria ka shpenzuar 461 milionë euro për tre muaj

PRISHTINË, 13 SHTATOR - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar llogaritë qeveritare të Kosovës në bazë tremujore. Ky botim paraqet pasqyrën e të hyrave dhe shpenzimeve qeveritare brenda kësaj periudhe (TM2 2018).

Shuma e përgjithshme e të hyrave të Qeverisë për TM22018 ishte 461

milionë euro.


Pjesën më të madhe të të hyrave e përbëjnë tatimet në produkte, të cilat paraqesin 73 për qind të totalit të hyrave, ndërsa pjesa e mbetur e të hyrave është shpërndarë në kategori të tjera të të hyrave.

Në TM2 2018, totali i përgjithshëm i shpenzimeve të Qeverisë ishte

441.8 milionë euro. Pjesën më të madhe të shpenzimeve e përbëjnë kompensimi i punëtorëve (34 për qind), kontributet sociale dhe përfitimet (26 për qind), formimi i kapitalit bruto (22 për qind) dhe konsumi i ndërmjetëm (11 për qind). Pjesa e mbetur e shpenzimeve është shpërndarë në struktura të tjera të shpenzimeve.



HARTAT E HAXHIUT SIPAS POROSIVE TË HASHIMIUT!



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

A po bashkohet Lugina a në Ujman po shpërthen turbina: Kohët e fundit presidenti ynë legjendar, e që po shkëlqen sidomos kur bie terri, përveç me Vuçiqin me të cilin e ka një lidhje adrenaline, më së shpeshti po takohet me shqiptarët e Luginës së Preshevës, të cilët thuaja i ka bindur se tashmë janë pjesë e Kosovës, vetëm se pritet korigjimi formal i kufijve. Realisht, me Behgjet Pacollin takohet online, kurse me Behxhet Shalën nuk takohet fare. Më ka eliminuar sikur të isha gylenist përballë Erdoganit. Po flitet se Hashimi, hartat e reja gjeografike, topografike, të biznesit e sidomos të pis-nesit i ka porositur në Turqi, te babai i Gëzimit, Rexhep Taip Erdogan. Se pse e bën këtë presidenti ynë legjendar e kam të qartë, por se pse këtë karrem me aq lehtësi po e gëlltisin shqiptarët e Luginës, assesi nuk e kuptoj, aq më parë që nuk është hera e parë që shqiptarët e Luginës mashtrohen nga liderë dhe lideruca nga Kosova, Maqedonia dhe sidomos Shqipëria. Shqiptarët e Luginës, të Malit të Zi dhe të Maqedonisë në vazhdimësi i janë nënshtruar një skizofrenie politike andaj kurrë nuk kanë menduar, vepruar apo bashkëvepruar si një trup i përbashkët edhe në çastet më të vështira, prandaj me ta kanë luajtur si kanë dashur, daçiqët, gjukanoviqët, gruevskët dhe të tjerët. Nuk e kam të qartë çka kërkojnë shqiptarët e Luginës te Thaçi dhe a e dijnë se janë duke e bërë argatin e drejt kundër Kosovës dhe kundër vet shqiptarëve të Luginës.

Me vetë faktin që ata bëhen pjesë e këtij skenari që luan me kufijtë e Kosovës, ata e përligjin çdo kërkesë të Serbisë për veriun e Kosovës dhe jo vetëm veriun sikur që e vënë në pikëpyetje pavarësinë e Kosovës. Kosova e ka shpallur pavarësinë me kufijtë ekzistues dhe, si e tillë, është pranuar nga 115 shtete dhe me Kushtetutë e ka bërë shprehimisht të qartë se nuk ka pretendime territoriale ndaj askujt sikur që e ka të ndaluar bashkimin me shtete të tjera. Shqiptarët e Luginës janë shtetas të Serbisë dhe ata duhet të kërkojnë të drejta në kuadër të këtij shteti sikur që serbët e Kosovës janë shtetas të Kosovës dhe realizimin e të drejtave të veta mund dhe duhet t'i kërkojnë vetëm brenda institucioneve të

Kosovës. Nëse serbët e Kosovës kërkojnë më shumë të drejta sa që iu garantojnë dokumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe Kushtetuta e Kosovës edhe shqiptarët e Luginës duhet të kenë kërkesa të ngjashme. Kërkesa e shqiptarëve të Luginës së Preshevës për bashkim me Kosovën, e sponsorizuar nga presidenti shkëlqesor Hashim Thaçi në formë të një rezolute e cila do të votohej në Kuvendin e Kosovës është një filluskë sapuni që nuk mund të jetësohet aq më parë që nuk ka asgjë konkrete se si do të realizohej ky skenar primitiv dhe i dëmshëm përkundër që disa kondomë të Hashimit, nën siglën e gazetarit, i kanë lëshuar disa balonë provues për të testuar disponimin e opinionit. E kam një mik të mirë psikolog dhe një ditë kërkova të m'i sqarojë ankthet që i kam për këtë çështje politike duke i thënë se mendimet e huaja (të Thaçit) kanë hyrë në kokën time dhe më shkaktojnë ankthe të vazhdueshme. E pyeta shkurt: Doktor, a jam unë i sëmurë a është Hashimi dhe a jam bërë edhe unë si shqiptarët e Luginës që po shkojnë pas Hashimit dhe po i besojnë edhe kur po iu shtet biftek në vend të koç... të dashit? E pata dëgjuar diku fjalën egzorciat me demok dikush qenka në gjendje t'ua heq shpirtat e lig nga trupi dhe e luta të ma heqë ankthin që nuk më lë të qetë një kohë të gjatë. Jo tha, mënyra më e mirë është ta zgjerosh ofertën e Hashimit dhe, përveç Luginës, duhet të bindesh se do ta marrim edhe Nishin, Prokupjen, Sanxhakun, Novi Pazarin, Plavën dhe Gucinë, Grudën dhe Hotin, Ulqinin dhe krejt Çamërinë. Ika nga miku im psikolog me mëmëritje se atë e paska përpunuar më herët dhe më shumë Thaçi, Vuçiqi, Daçiqi dhe drejt dhe i biri. Rezoluta e propozuar nga shqiptarët e Luginës dhe e sponsorizuar nga Thaçi është me hile dhe nuk duhet, as të votohet dhe as të kalojë (nëse eventualisht do të votohej) nga deputetët e Kuvendit të Kosovës sepse në këtë mënyrë deputetët e Kosovës do ta përligjin ndarjen e Kosovës dhe e dhunojnë Kushtetutën e vendit. Hashimi po e luan lojën e Ponti Pilatit i cili, pas gozhdimit të Krishtit, i lau duart duke e liru veten nga çdo përgjegjësi. Presidenti ynë shkëlqesorë do të veprojë pikërisht si Ponti Pilati, e ka të qartë se kjo Rezolutë do të dështojë sepse është e dështuar që në ngizje dhe pastaj për mosvotim të saj do ta akuzojë opozitën dhe një pjesë të pozitës se janë kundër bashkimit të Luginës me Kosovën dhe se janë kundër bashkimit kombëtar! Kjo është loja ku Hashimi është Maradonë, kurse kundërshtarët politikë janë si lojtarët e Ishujve Faroe krahasuar me

Maradonën. Asnjë politikan apo qytetar i Kosovës nuk duhet të pranojë të bëhet pjesë e një skenari ku flitet për kufirin e Kosovës përjashtuar demarkacionin me Serbinë e që ky shtet nuk do ta pranojë, por as që do të kushtëzohet nga BE-ja sikur që për këtë nuk u kushtëzuan shtetet e dala nga shkatërrimi i ish-Jugosllavisë, përjashtuar këtu Kosovën. Janë përralla pohimet se Serbia do ta pranojë Kosovën dhe se Kosova do të bëhet anëtare e Kombeve të Bashkuara nëse bëhet korigjimi i kufijve. Janë këto mashtrime ordinere dhe të ulëta. Serbia do ta pranonte njohjen e pavarësisë së Kosovës vetëm nëse e merr veriun e Kosovës si tërësi, e merr një pjesë të Anamoravës, një pjesë të llapit, një pjesë kah Dukagjini, nëse siguron kapacitet dhe status eksteritorial për manastiret, kishat dhe pronat kishtarë që do të mbesin jashtë territoreve që do t'i merrte Serbia dhe si kundërvlerë do të pranonte që pjesë e Kosovës të bëheshin disa fshatra të Luginës së Preshevës me xhamitë e ndërtaura nga Erdoganit e që për kryeqytet do ta kishin qendrën e njohur politike, kulturore, ekonomike, e sidomos biznesore, e njohur dhe e pranuar në gjithë, Tërmovcin e njohur sidomos nga Interpoli. Po e shihni që korigjimin e kufijve po e përkrah edhe Kuperi i cili e dhunonte skajshmërisht ekipin nga Kosova në bisedimet "teknike" me Serbinë e që udhëhiqeshin nga një mashtruese dhe gënjeshtarë ordinere siç ishte Zezdita (Fjolla) Tahiri e cila sot, sikur dikur Azem Vllasi kur u shkartinat nga babai politik - Millosheviqi, u bë patriot i dërrasave, edhe Zezdita po "alarmon" nga rreziku për këto bisedime, pasi na pati kripur me rrena se në këto bisedime po mbrohej pavarësia dhe sovraniteti i Kosovës dhe se Serbia do ta njohë Kosovën. Kujt i kujtohet sot emri i Robert Kuperit përveç atyre që janë takuar me të dhe nuk kanë pasur guxim ta thonë edhe një fjalë të vetme në mbrojtje të Kosovës? Apo, kujt i kujtohet një bukuroshe siç ishte baronesha Ashton nëse nuk do të ishin puthjet pasionante me presidentin tonë historik, atëherë kryeministër i Kosovës, zotni Hashim Thaçi?! Edhe sot Frederika Mogerini, nga një familje e spikatur në Itali në luftë kundër kriminit të organizuar dhe luftë ndaj atyre që trafikojnë me narkotikë (në realitet është e kundërta e saj), një burokrate në përfundim të mandatit së bashku me Johanes Hanim (mbiemrin e ka të një miku tim nga Veleshta Hani) po bëjnë presion që të arrihet një marrëveshje e ngutshme midis Vuçiqit dhe Thaçit duke u radhitur në anën e Serbisë, aq më parë që në çdo variant Serbia do të dalë fituese nga kjo marrëveshje. Nëse Serbia, pas për-

fundimit të marrëveshjes histo(e)rike midis dy liderëve autokratë, Thaçit dhe Vuçiqit, nga Kosova e merr edhe një qerre me dru, atëherë është fituese dhe kjo nuk do të duhej të pranohej. Jam i sigurt se çdo korigjim i kufijve do të sjellë luftë të re në Kosovë thuaja menjëherë dhe se kjo luftë nuk do të mund të izolohej vetëm në Kosovë. Gjithashtu, jam i sigurt se çdo bashkësi e komunave serbe, si pushtet i tretë, do të sillte luftë dhe spastrim etnik në një periudhë të mëvonshme.

Ekipi negociator i propozuar, pa kredibilitet politik dhe kombëtar: Qeveria e ka propozuar një ekip negociator vetëm me kandidatë të pozitës, por se e ka lënë si mundësi që të plotësohet edhe nga opozita dhe shoqëria civile. Për kryesues është propozuar Fatmir Limaj, kurse anëtarë janë: Enver Hoxhaj, asnjëherë anëtar i PDK-së por, paradoksalisht, i propozuar si anëtar i PDK-së; Behgjet Pacolli, si përfaqësues i Kamerunit dhe Kazakistanit i cili, kurrë në jetën e vet nuk e ka bërë një angazhim të hairit për Kosovën dhe shqiptarët; Dardan Gashi që, seriozisht nuk e kam të qartë, kël e përfaqëson dhe cilit subjekt politik i kalon, të mbitokës apo nëntokës; Mahir Jaghillari që nuk ka informata elementare se çka po ndodh me të dhe rreth tij, por se gjithmonë është në pushtet, në të gjitha kohët si dhe Avni Arifi të cilin askush nuk e pyet se sa kushton pazari i qenve e lëre më të vendosë për kufijtë e Kosovës. Nga ky grup të cilit do t'i kishte lakmi edhe baroni Minhausen, autoriteti i pranuar në planin ndërkombëtar për emancipimin dhe shpërndarjen e rrenës, vetëm dy veta kanë kontribuar për lirinë e Kosovës, duke sakrifikuar edhe jetën, kurse të tjerët, ose kanë qenë në shërbim të Serbisë, ose e kanë kaluar kohën duke kruar koçet. E këta të na përfaqësojnë në bisedime me Serbinë!! Kurrë dhe asnjëherë. Jam për atë që ekipi negociator të ketë më shumë anëtarë të opozitës, kurse shoqëria civile duhet të jetë vetëm si ndihmuese, këshilluese dhe jo anëtare sikur që çdo anëtar duhet t'i bëhet verifikimi i së kaluarës dhe të cilët do të merrnin përgjegjësi për këto bisedime dhe do ta nënshkruanin një deklaratë që do ta nënkuptonte marrjen e përgjegjësisë dhe jo vetëm të honorarëve. Nëse mbetet në mëshirën e këtij grupi të propozuar, në mesin e të cilëve ka edhe antikombëtarë, sekserë dhe moralisht të diskredituar, atëherë edhe po ta kishim hapësirën territoriale të Kinës, nuk do të mjaftonte t'i përmbushim apetitet e Serbisë. Ku grup negociator dhe me këtë përmbajtje nuk duhet as të votohet e lëre më të mandatohet për bisedime me Serbinë! Ndryshe na rrou drejt, së bashku me berberin e

Sevilas (Shumadisë), Aleksandar Vuçiqi. Opozita jo që do të duhej ta kundërshtonte formimin e ekipit negociator, por do të duhej të insistonte që të formohej dhe ajo ta ketë rolin kryesor, duke ua bërë me dije në Bruksel, se asnjë marrëveshje në dëm të Kosovës nuk do të kalojë. Kështu, duke bërë zhurmë në Prishtinë dhe në Kuvendin e Hajkobilës, vetëm sa do ta forcojnë këtë Grup të Hurit dhe të Konopit, ku pjesa antikombëtare është mbizotëruese në vendimmarrje eventuale. Nuk shoh rrugë tjetër! Edhe më herët kam shkruar dhe deklaruar se lufta në këto bisedime nuk po bëhet për kufij dhe territore, por për mbushjen e asociacionit të komunave serbe me fuqi ekzekutive. Jam pshurrur së qeshuri dhe më kapi shkulja - diarreja (mendova nga virusi) e po del se është nga kërcënimi i AKR-së dhe Gjet Pacolli se, nëse preket Mitrovica, atëherë kjo parti e madhe dhe përcaktuese për të gjitha zhvillimet lokale dhe globale do të tërhiqet nga koalicioni! Po na shkërdhejnë nga të gjitha pozitat!

Tash edhe PDK-ja (me dy kryetarë) ka filluar ta kundërshtojë Hashimin dhe lojërat e tij me kufij. Uroj që ky kundërshtim të mos bëhet sipas direktivave të BE-së apo, saktësisht ta them, të Hashim Thaçit! PDK-ja është dashur menjëherë ta kundërshtojë këtë çmenduri e jo të reagojë pasi të falet Bajrami. Në këtë kontekst më parimore janë treguar LDK-ja me së paku 10 kryetarë, Alternativa me gjithsejtë 2 anëtarë, LV-ja refuzon çdo propozim në mënyrë reflektive nëse vjen nga PDK-ja dhe Thaçi, PSD-ja e Kaçusha Jasharit është diku në mes etj.

Unë "protestoj": Para 10 ditësh në një shkrim pata parashikuar se protesta e organizuar nga një grup qytetarësh do të dështojë sepse këta protestues recidivistë dhe shëtitës nuk kanë kondicion për shtigje të gjata dhe nuk kanë kapacitet të krijojnë një masë kritike të qëndrueshme e cila do të ndikonte të bëheshin ndryshime. Më në fund, vetë e ngrenë flamurin e bardhë të dorëzimit e që është shumë më mirë se protestat që zbeheshin dhe pakësohej numri i protestuesve, deri në tre musketarët e fundit. Situata, ndonëse, po të ishte e tillë në vende të tjera, do të nxirrte në protesta me lehtësi 100 000 protestues e, ndoshta, edhe më shumë, në Kosovë lehtësisht amortizohet nga politikanët e vendit dhe ndërkombëtarët. As partitë politike nuk kanë kapacitet që për një kohë të gjatë të sigurojnë pjesëmarrje të madhe të protestuesve. Protestat e organizuara në Kosovë rëndomë dështojnë, prandaj nuk prodhojnë ndryshime, kurse vetëm protestat spontane mund të prodhojnë ndryshime dhe rezultate. Në Kosovë ka të ngjarë të ndodhin këso

protestash sikur edhe të formohen grupe që edhe me mjete të tjera do ta kundërshtonin politikën aktuale, nëse në të vërtetë Kosova do ta merrte "vellika teposhtëzën", sipas zhargonit rahovecian. Uroj të përfundojë mirë dhe pa pasur nevojë për sakrificë të tjera!

Prostitucioni politik dhe informativ: Në vendet me një demokraci të pakonsoliduar politikanët kryesisht identifikohen si prostituta politike, pa hyrë në sqarime për këtë epitet, edhe të pamerituar. Politikanët duhet ta bëjnë të kundërtën e prostitucionit sepse për këtë e kanë marrë mandatin. Nëse dikush e ka të legalizuar aktivitetin e prostituimit dhe për këtë, jo që nuk sanksionohet me ligjet në fuqi, por se shpërblehet me miliona e miliona euro të taksave tona, është Radio Televizioni i Kosovës me akronim RTK sepse edhe me letra, përveç aktivitetit të dëshmuar deri më tani, është e vetmja shtëpi publike me letra në Kosovë. Tash, si prostituta të dëshmuara dhe ligjërisht të mbrojtura, duan t'u kërcejnë së paku 500 000 qytetarëve të Kosovës duke ua fryrë faturat e energjisë elektrike për 2.5 euro për njehsorë në kohën kur kjo shtëpi e vetme publike me letra në Kosovë nuk prodhon fare rrymë - programe, përveç pordhave dhe fendëve të politikanëve që shkërdhohen me ta!

Nexhmedin "trimi" dhe haxhiqamilët e Drenicës: Nexhmedin Spahiu më duket se është me profesion matematikan, ndonëse matematika politike kurrë nuk i del ashtu si e mendon sepse shifrat ia ngatërrojnë gjykimin e drejtë. Nuk e them që nuk është i ditur, madje është shumë i ditur sepse fort ka dëshirë të hyjë dhëndër me koç... të tjerëve. Pas protestës së banorëve të Drenicës që, me të drejtë e penguan hyrjen në Drenicë të Aleksandar Vuçiqit, i cili e ka një të kaluar të qartë kriminale dhe ka përgjegjësi konkrete për krime në Drenicë dhe Kosovë, Nexhi i sulmoi ashpër protestuesit, duke i quajtur haxhiqamilë, sepse qenka dashur të protestojnë në veri të Kosovës derisa Nexhi i kruante bol... në jug të Mitrovicës apo Novi Pazar. E pamoralshme është kjo Nexh, qoftë edhe nëse thuhet nga ekselencia juaj. Drenicasit do të turpëroheshin po ta linin Vuçiqin të shkelë mbi varret e Adem, Shaban dhe Hamëz Jasharit, të Fehmi dhe Xhevë Lladrovit, Ilaz Kodrës dhe "Sandokanit", Azem Bejtës dhe Shotë Galicës, Shaban Polluzhës dhe Mehmet Gradicës, Tahir dhe Nebi Mehës dhe të gjithë të tjerëve. E kuptoj dhe bashkëndiej shuumë me dhembjen e serbëve që nuk e takuan kryetarin e tyre me të kaluar kriminale, por sakrificë e dëshmorëve të përmendur më lart dhe të gjithë të tjerëve është mbi të gjitha dhe gjithmonë do të mbetet ashtu. Unë nuk pata guxim të bëhem pjesë e protestës në Drenicë, prandaj nuk kam asnjë të drejtë që në mbrojtje dhe arsyetim të cqarllëkut tim, t'i quaj haxhiqamilë ata që e kryen detyrën njerëzore, kombëtare dhe morale. As ti Nexh nuk e ke këtë të drejtë! Ish, ish pra Nexh!

Vepra e Astrit Thaçit do të jetojë gjatë

RAHOVEC, 13 SHTATOR (ER) - Të enjten i është dhënë lamtumira e fundit në fshatin Kramovik, këshilltarit në Kuvendin Komunal të Rahovecit, Astrit Thaçit, i cili, pas një sëmundje të shkurtër, ka ndërruar jetë të martën. Në sallën e mbledhjeve të Kuvendit Komunal të Rahovecit është mbajtur mbledhje përkujtimore në nderim të jetës dhe veprës së Astrit Thaçi, këshilltar në Kuvendin Komunal të Rahovecit nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës.

Afrim Dina, kryesues i Kuvendit Komunal të Rahovecit, në fjalimin e tij ka thënë se e ka shumë të vështirë të pajtohemi se po mban fjalë mortore për kolegun që deri dje ishte përkrah tyre. "E kam të pamundur ta bind veten dhe juve



se më nuk është në mesin tonë një prej kolegëve dhe bashkëpunëtorëve të palodhshëm. Vdekja e hershme dhe e papritur e kolegut tonë na ka tronditur të gjithëve. Nuk do të dorëzohemi para kësaj humbjeje të madhe. Do të jemi krenarë që e patëm në mesin tonë. Vepra e Astritit do të jetojë gjatë, ndërkaq

puna dhe entuziazmi i tij do të na shërbejnë si frymëzim në rrugëtimin tonë, tashmë pa të", ka thënë Dina.

Në fjalën e tij kryetari i komunës, Smajl Latifi, ka thënë se lajmi për humbjen e Astritit i ka lënduar shumë. "Ishte një lajm që të bie si gur në shpirt dhe të shkakton trazim. E kam njohur atë para

angazhimit në jetën publike dhe e kam vlerësuar shpirtin e tij human e atdhetar. Duke qenë se jemi produkt të një tërësie shoqërore dhe hallet e shqetësimit i kemi pasur të ngjashme dhe se nga ne kërkohej angazhim i përbashkët për t'i tejkaluar sfidat, Astriti u rreshtua aty ku i takonte, duke e përmbytur obligimin qytetar. Edhe pas përfundimit të luftës Astriti nuk pushoi së punuari për përmirësimin e gjendjes ekonomike të familjes dhe shoqërisë tonë", ka deklaruar Latifi.

Ndërsa Rasim Fazliu, shef i grupit i këshilltarëve të PDK-së, në fjalimin e tij u shpreh se e kemi pranuar me pikëllim dhe dhembje të madhe lajmin për ndarjen e hershme dhe të papritur nga jeta të Astrit Thaçit.

Prokuroria e Gjakovës fillon hetimet për listat e veteranëve të UÇK-së

GJAKOVË, 13 SHTATOR (ER) - Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Gjakovë, Ali Selimaj, ka pritur në takim prokurorët e kësaj prokurorie, ku ka caktuar dy prokurorë të cilët do të merren me trajtimin e listave të veteranëve të UÇK-së, të

cilat janë duke u dyshuar për manipulime.

Kryeprokurori Selimaj ka kërkuar nga prokurorët e caktuar në këtë detyrë t'i shtojnë veprimet hetimore për rastin e mashtrimeve me listat e veteranëve të luftës. Po ashtu, Prokuroria e Gjakovës

në koordinim të plotë me Njësinë e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsion në Gjakovë, ka filluar hetimet paraprake për identifikimin dhe verifikimin e 191 personave të dyshuar si veteranë dhe akterët e tjerë të përfshirë në procesin e rekrutimit, të cilët



dyshohen se kanë kryer veprat penale "falsifikim i dokumentit", "mashttrim dhe legalizim i përmbytes së pavërtetë". Vlen të theksohet se Prokuroria Themelore në Gjakovë është e përkushtuar ta trajtojë çdo rast me seriozitetin më të lartë moral dhe profesional.

Komuna e Mitrovicës dhe Kolegji IBCM do ta vazhdojnë bashkëpunimin



MITROVICË, 13 SHTATOR (ER) - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka pritur në një takim drejtoreshën e Kolegjit Ndërkombëtar IBCM në Mitrovicë, Mihane Kerolli, me të cilën ka biseduar për bashkëpunimin e deritashëm dhe për mundësitë e thellimit dhe zgjerimit të këtij bashkëpunimi.

Fillimisht kryetari Bahtiri dhe drejtoresha Kerolli e kanë vlerësuar të suksesshëm bashkëpunimin e deritashëm ndërmjet komunës dhe këtij kolegji, duke shtuar se ka gatish-

mëri dhe mundësi reale për ta zgjeruar dhe thelluar këtë bashkëpunim.

Në takim është biseduar edhe për çështjen e regjistrimit të ndërtesës së Kolegjit IBCM dhe për mundësinë e vazhdimin të kontratës për shfrytëzimin e pronës komunale. Bahtiri ka premtuar se do ta vazhdojë mbështetjen e Kolegjit IBCM edhe në të ardhmen, duke përfshirë këtu të gjitha kërkesat që janë në suazat ligjore dhe brenda mundësive që ka Komuna e Mitrovicës.

MMPH-ja me projekt 170 mijë euro për Komunën e Shtimes

SHTIME, 13 SHTATOR (ER) - Ushtruesi i detyrës së ministrit të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fatmir Matoshi, së bashku me kryetarin e Komunës së Shtimes, Naim Ismajli, kanë nënshkruar një memorandum bashkëpunimi për realizimin e projektit "Zgjerimi dhe pastrimi i lumit Caralevë-Shtime dhe Mollopolc-Petrovë-Shtime-Vojnovc", në vlerë prej 170 mijë eurosh, financiar nga MMPH-ja. Gjatë ceremonisë së nënshkrimit ministri Matoshi ka thënë se përmirësimi i gjendjes së lumenjve në Kosovë është një

nga detyrat dhe prioritetet e MMPH-së. "Zgjerimi dhe pastrimi i lumit Caralevë-Shtime dhe Mollopolc-Petrovë-Shtime-Vojnovc është një projekt mjaft i rëndësishëm për Shtimen, qytetarët e saj dhe mjedisin në përgjithësi, i cili do të ndikojë në ruajtjen e biodiversitetit", ka thënë Matoshi.

Ndërsa kryetari i Komunës së Shtimes, Naim Ismajli, ka falënderuar ministrin Matoshi për këtë projekt, ndërsa ka theksuar se e rëndësishme për komunën që ai drejton është edhe çështja e ujëmbledhësve. "Me



ushtruesin e detyrës së ministrit Matoshi biseduar edhe për mundësinë e ujëmbledhësve në Komunën e Shtimes. Është një mundësi e mirë që Kosova të ketë edhe një pikë referimi për

ujëmbledhës", ka thënë Ismajli. Matoshi dhe Ismajli kanë diskutuar edhe për përgatitjet për aksionin "Ta pastrojmë Kosovën", i cili fillon më 15 shtator.

(Referim rreth vëllimit poetik "Porta të hapura" të autores Shefqete Gosalci)

POEZIA QE TA RIKUJTON NAIMIN E MADH

**Nga Rami KAMBERI**

"Sa herë terri ngrin në kënd,
Mbështjell prej zërash anonimë,
Thërras me zë imazhin tënd,
Dhe fle me ty, i shtrenjti im.

Pranë teje ndihem kaq e plotë,
Si hënë në qiellin plot shkëlqim,
Harroj në çast çdo brengë në botë,
Shpërthej çdo burg e çdo rrethim.

E paharruar ajo ditë,
Mbështjell tek ti në përqaftim,
Në sytë e mi ti zbritte yjet,
Me lë përjetë në ëndërrim.

Kam ftohtë këtë mbrëmje,
Tek thith këtë ajër pa kuptim,
Më mirë të vdes nën frymën tënde,
Sesa pa ty i shtrenjti im.

Të rrallë janë poetët e poeteshat që poezinë e nxjerrin nga shkuli i tokës me gjuhën e shpirtit, mu ashtu siç e bëri flamurtari i parë mes nesh, i madhi Naim Frashëri, i cili, me punën e vet, jo vetëm që na rikujtoi dhe na e nxori nga harresa historikun e kombit tonë, por edhe na e tregoi gjeografinë që na takon si komb, pas një heshtje të madhe ndër shekuj, që nga koha e Motit të Madh, kur shpata e Skënderbeut me gjuhën e gjakut e shkruante motin për kohën, që sot mes nesh ta kenë fjalën flamuri dhe gjuha, që na e tregojnë gjeografinë e Atdheut, gjeografi që edhe sot e kësaj dite përgjaket gjithandej, për t'u ringjallur si në motin kur mbi truall të kësaj gjeografie liria frymonte shqip. Dhe, pas shumë kohësh, pas Naimit të madh, për gjeografinë e kësaj gjuhe, me një stil të veçantë poetik, por me ngjyrat e njëjta të dashurisë dhe atdheut do të na shfaqet në poezinë e saj edhe poetesha Shefqete Gosalci, që të kaluarën dhe të tashmen i lidh me ngjyrat e qëndresës me poezitë që rresh-tohen njëra pas tjetrës brenda librit, që mban piramidën e artit, për t'i thënë pedestalit poezi derën lërë hapur, me ngjyra jete, që për këtë piramidë dhanë jetën për ta sfiduar vdekjen.

Pra, unë mendoj që jo rastësisht poetesha Shefqete Gosalci vëllimin më të ri e ka pagëzuar "Porta të hapura" brenda së cilës me gjuhën e atdhetarizmit flasin:

- moti i së kaluarës,
- moti i përjetimit,
- moti i së tashmes dhe,
- moti i së ardhmes.

Them kështu pasi struktura, më mirë thënë arkitektura e poezive, është e vendosur me një mjeshtri të rrallë në hapësirën kohë, dhe jo rastësisht më lart u shkrua se poezia e Shefqete Gosalci na e kujton Naimin e madh, i cili në secilën poezi apo më mirë thënë, se: Secilën poemë dhe vepër e vendos në kohën e saj, sa për të na kujtuar se kush ishim ne, shqiptarët, që botës i dhamë aq shumë saqë nga ajo morëm vetëm dhimbje, plagë, luftëra dhe gjeografi varresh, të cilat edhe sot e kësaj dite ose flasin në

gjuhë të huaj, ose ende janë rob i pluhurit të harresës.

Duke mos dashur, që më tej, të mbetem mes vijës së poezisë Naim-Shefqete, do të përcaktohem vetëm tek poezia Shefqete, që me odeonin e saj, shtrihet:

- në qëndresë,
- në guxim,
- në shtegun bashkim.

Që të tri pikat në fjalë, të cilat burimin e kanë nga përjetimi i poetes, e cila rrugës së ardhmërisë eci drejt dhe ballëhapur mbajti qëndrim kundër robërisë dhe tradhtisë, qoftë si aktiviste dhe pjesëmarrëse nëpër motet e demonstratave, qoftë si pjesëmarrëse në luftën që hapi Adem Jashari, luftë kjo në të cilën Shefqetja kaheër ishte përcaktuar, si shteg i vetëm se si duhet të bëhet ecja për:

- gjuhë,
 - komb,
 - atdhe,
- Për të arritur deri te:
- bashkimi dhe,
 - liria.

Dhe, besoj se nuk është e tepërt po që se themi se poezia e poeteshe Shefqete Gosalci jo rastësisht mban titullin "Porta të hapura" që, po të lexohet me ndjenjën e kombëtares, lirshëm mund të themi se ky titull flet më shumë se që mund të themi: u çliruam, ngaqë vetë poezitë na thonë, që portat për kombin tonë, ende janë të hapura, për t'u mbyllur, që të themi jemi:

- një gjuhë,
- një komb,
- një atdhe,
- një shtet,
- një flamur.

Ata që, sipas poezisë "Porta të hapura", të poeteshe Shefqete Gosalci, i mungojnë

**Shefqete Gosalci**

kombit tonë, për të thënë: u bashkuam, u çliruam.
Ndaj së fundmi, lirshëm mund të them

se: veptra në fjalë e poetes Shefqete Gosalci është një përgjithësi e poezisë së sotme shqipe, që na fton ta kuptojmë kohën, brenda këtij moti, që na ngufat, me ngjyrën jermi të lirisë, që nuk dimë si ta pagëzojmë:


- si ndarje e një kombi,
- pajtueshmëri me tradhtitë e fuqive të mëdha apo,
- kaq mundem të bëjmë, mes një robërie të madhe.

Dhe besoj se poetesha Shefqete Gosalci, me mesazhet e veta në përgjithësi si:

- përsosje morale,
 - kultivimi për bashkim,
 - shkulje të tradhtisë dhe,
 - të kuptuarit atdhe e bashkim.
- Pra, në kuptimin e plotë të pikave të lartshënuara, të cilat na shpijnë deri tek kuptimi:

- Një Shqipëri e lirë,
 - krenare,
 - e përparuar,
 - dinjitoze përball kombeve të tjera...
- Sikur na e qep jetën me lumturi mu ashtu siç e do poetesha dhe ata, heronjtë dhe dëshmoret e kombit, që këtij ideali i dhanë me të shtrenjtën, jetën.

Më shumë se kaq nuk do të thosha, ngaqë mendoj dhe besoj se vetë poezia "Porta të hapura" do të flasë më shumë mes lexuesve. Prandaj edhe një herë jam i obliguar moralisht, që të them se: veptra e poeteshe Shefqete Gosalci është përgjithësi e poezisë së sotme atdhetare, ku duhet ta gjejmë forcën morale shqiptarët, ta lexojnë e rilexojnë, ta mësojnë edhe përmendesh për ta larguar pesimizmin kolektiv, nga frika se vërtetë qëndron thënia e At Fishtës, mjerë popujt e vegjël që kalojnë nëpër duart e fuqive të mëdha.

**Vëllimi poetik "Porta të hapura"**


E jashtëzakonshme

Gjendet vula e vjetër 2 700 vjeçare

Arkeologët kanë zbuluar një vulë të vjetër 2 700 vjet të epokës së Mbretërisë Urartu në provincën turke Elazığ, ka raportuar "Anadolu Agency". Vula është gjetur në Kështjellën Harput, ku një ekip arkeologësh janë duke kryer gërmime në krye me profesorin Ismail Aytaç.



FOTO E DITES



Një fermer nga provinca Dong Thap i Vietnamit mbledh margaritare të verdhë përpara se t'i dërgojë në treg në përgatitje për vitin e ri hënor, i njohur si Tët. /nationalgeographic/

E rrallë

Fiton pesë milionë euro në lotari, i bie të fikët

Me një biletë lotarie 'gërvisht dhe fito' prej 20 eurosh, fitoi pesë milionë. Por, surpriza ka qenë aq e fortë, sa që milionerja fatlume ka humbur ndjenjat pikërisht brenda kinkalerisë në Grosseto, Itali, ku kishte blerë biletën. Gruaja, banore e atij qyteti dhe kliente e zjarrtë e lokalit që ndodhet dy hapa



larg gjykatës, kur e rimori veten, festoi fitoren dhe më pas është larguar pa lënë gjurmë.

BARSOLETA E DITËS



Nëna: Afrim, çohu se djali e ka përmbi një plumb!
Afrimi: O pashë Zotin mos e drejto kah unë.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 16:00

"HOTEL TRANSYLVANIA; Summer Vacation" 3D

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 orë 37 min

Rolet: Adam Sandler, Selena Gomez, Andy Samberg, Kevin James, David Spade, Steve Buscemi, Molly Shannon, Mel Brooks, etj.

Regjia: Genndy Tartakovsky



Në ora 18:00

"THE DARKEST MINDS"

Fantastiko-Shkencor/Triller; 1 orë 45 min

Rolet: Bradley Whitford, Amandla Stenberg, Mandy Moore, Gwendoline Christie, etj.

Regjia: Jennifer Yuh Nelson



Në ora 20:00 dhe 22:00

"THE PREDATOR" 3D,

Aksion/Aventure/Horror; 1 orë 47 min

Rolet: Boyd Holbrook, Trevante Rhodes, Jacob Tremblay, Keegan-Michael Key, Olivia Munn, Sterling K. Brown, Alfie Allen, Thomas Jane, Augusto Aguilara, Jake Busey, etj.

Regjia: Shane Black



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.




DASHI

E shkuara dhe marrëdhënia me një ish-partner sot do të dalin në sipërfaqe. Nuk do të jetë aspak e lehtë të gjeni justifikime në një debat.



DEMI

Jeni pak në ankth sot dhe nuk po e kuptoni nga ju vjen. Dita nuk do të jetë e qetë sepse shumë mendime po jua turbullojnë mendjen.



BINJAKËT

Duhet të sqaroni sa më parë një keqkuptim të lindur sepse duke e neglizhuar do të thellohen më shumë mosmarrëveshjet.



GAFORRJA

Po mundoheni të ambientoheni me të rejtat e fundit që po ju ndodhin. Edhe pse ka shumë rrëmujë rreth e qark jush do të arrini ta gjeni oazën tuaj.



LUANI

Nuk është se keni ndryshuar mendim lidhur me një person të caktuar, por disa situata të reja ju kanë bërë më dyshues dhe më të vëmendshëm.



VIRGJËRËSHA

Jeni të fokusuar tek familja sot dhe doni t'ua plotësoni pjesëtarëve të saj çdo dëshirë që ju kanë shprehur. Kjo gjë ju lumturon pa fund.



PESHORJA

Pak lëvizje në çift nuk bën aspak keq, madje është mënyra për ta shijuar më mirë marrëdhënien. Do të jeni shokë shumë të mirë udhëtimi sot.



AKREPI

Sot jeni zgjuar me humor të keq dhe karakteri juaj nuk do të jetë i thjeshtë për t'u duruar përgjatë orëve të ditës.



SHIGJETARI

Do të merrni sinjale që fillimi i ditës do të jetë i mbushur me ndryshime dhe surpriza. Duhet të filloni që tani të ambientoheni.



BRICJAPI

Nuk është se sot planetët do të jenë në rrugën tuaj. Shumë herë do të keni çaste tensioni gjatë ditës që do t'ju duhet t'i përballoni vetëm.



UJORI

Edhe pse në çaste të caktuara të ditës pozitativat tuaja do të lëkundin ndjeshëm, jeni aq të fortë si karaktere sa do të arrini t'i ktheni situatat në favorin tuaj.



PESHQIT

Një ditë jo e mirë dhe pa asnjë lekë të kursyer. Keni shpenzuar kot kohët e fundit për gjëra që nuk i keni pasur të domosdoshme.

Rina dhe Sin Boy, tre milionë për një javë



Rina Balaj dhe Sin Boy kanë publikuar kohë më parë videoklipin e ri. Dy këngëtarët e rinj kanë publikuar një videoklip me këngë mjaft ritmike. Kënga u pëlqye mjaft shumë qysh në ditët e para të pub-


likimit. "Gigi" është kënga e fundit e publikuar e dyshes me videoklip. Kënga u realizua nga Zzap n'Chriss me tekst të artistëve. Ndërkaq, videoklipi i cili arriti tre milionë klikime u punua nga "FilmNation".

Ariana Grande, e shkatërruar pas vdekjes së Mac



Vetëm pak ditë më parë u nda nga jeta reperi i njohur Mac Miller duke shokuar fansat e tij të cilët mbushëm me komente "Instagramin" e të dashurës, këngëtares Ariana Grande. Ata e fajë-

sonin atë për vdekjen e Mac dhe e detyruan këngëtares t'i bllokonte të gjitha komentet. Ariana nuk ka pasur asnjë reagim publik në lidhje me ngjarjen por, thjesht, ka postuar një fotografi bardh e zi të ish të dashurit.




Rihanna shkëlqen në Javën e Modës në Nju Jork

Ajo shfaqti koleksionin e fundit "Savage x Fenty" gjatë Javës së Modës në Nju Jork. Rihanna ishte në humor të mirë për të festuar pas shfaqjes së saj triumfuese në pasarelë, duke shkëlqyer me të dy fustanet që kishte zgjedhur

si gjatë ngjarjes, por edhe në festën pas shfaqjes. Minifustani i zi prej lëkure që e tregonte tepër sensuale ishte i duhuri për kthimin e saj si protagoniste, teksa këngëtarja nga Barbados "rrëmbeu" vëmendjen e paparacëve.

Alex Rodriguezi tregon se çfarë i pëlqen te Jennifer Lopezi

Alex Rodriguezi duket se mund të flasë pa ndalur për të dashurën e tij, Jennifer Lopez. Legjenda 43-vjeçar i bejsbollit ka folur së fundmi për atributet më të mira të Lopezit në intervistën për revistën "Cigar Aficionado" për muajt shtator-tetor. Rodriguezi e quan superyllin të bukur derisa e lavdëron për punën që e bën si nënë të binjakëve dhjetëvjeçarë, Max dhe Emme, që i ka me ish-bashkëshortin Marc Anthony si dhe për kujdesin ndaj fëmijëve të tij.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

DORTMUND V EINT. FRANKFURT

3+

UNION BERLIN - MSV DUISBURG

2

AC AJACCIO - PARIS

1

'Profa': Për titull flasim në janar

Bylbyl Sokoli të enjten për "Epokën e re" nuk ka pranuar se Llapi synon titullin e kampionit në këtë kampionat. Për synimet e këtij klubi "Profa" ka thënë se mund të flasë vetëm në muajin janar. "Llapi nuk e ka synim kryesor titullin, por synimi ynë është të tregojmë lojëra sa më cilësore, pa e mohuar se kemi potencial për të luftuar për pjesën e sipërme të tabelës. Gjithçka që ne synojmë është të vijmë te rezultatet në saje të punës. Synim më të saktë të skuadrës së Llapit mund ta jap vetëm pas përfundimit të sezonit vjeshtor, pra në muajin janar", ka thënë Sokoli

EPOKA ERE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 13 SHTATOR - Trajneri Bylbyl Sokoli po arrin rezultate të mira në këtë fillim të kampionatit në IPKO Superligë, por vazhdon të qëndrojë me këmbë në tokë. "Profa" të enjten për "Epokën e re" ka thënë se Llapi nuk e synon titullin e kampionit, por shfaqjen e lojërave të mira. "Llapi nuk e ka synim kryesor titullin, por synimi ynë është të tregojmë lojëra sa më cilësore, pa e mohuar se kemi potencial për të luftuar për pjesën e sipërme të tabelës. Gjithçka që ne synojmë është të vijmë te rezultatet në saje të punës. Një synim më të saktë të skuadrës së Llapit mund ta jap vetëm pas përfundimit të sezonit vjeshtor, pra në muajin janar", ka thënë Sokoli.

Trajneri i njohur në Kosovë dhe ish-përzgjedhësi i Përfaqësueses së Kosovës është angazhuar nga kryesia e Llapit me synim që me përvojën që ka ta sjellë titullin në Podujevë. Lidhur me këtë çështje Sokoli ka deklaruar: "Titulli nuk synohet me çdo kusht, por lojërat e mira. Lojtarët po japin maksimumin dhe besoj shumë që se shpejt do të vijmë te loja që e dëshirojmë". Llapi në ndeshjen e parë ka befasuar për të keq, pasi ka humbur nga Drenica dhe, për këtë fakt, është kritikuar mjaft shumë. Sokoli ka thënë se tri fitoret e fundit nuk janë kundërpërgjigjeje për kritikët, por detyrë e skuadrës. "Unë së bashku me shtabin teknik

dhe lojtarët po punojmë për ta nxjerrë maksimumin nga ekipi, kurse analistët dhe të tjerët kanë drejtë të kritikojnë, pasi një gjë e tillë është sportive. Me rëndësi që po bëhet një punë e mirë në klub, kurse rezultatet do të vijnë

Flamurtarit, që është lider dhe befasia e këtij kampionati. Sokoli lavdëron kundërshtarit, por lë të nënkuptohet se Llapi synon maksimumin e pikëve. "Flamurtari ka një kryesi, trajner dhe skuadër të mirë, prandaj nuk është rastësisht në pozitën e parë. Ne do ta analizojmë këtë ndeshje derbi dhe do të përpiqemi, me angazhimin e të gjithëve, të marrim rezultat pozitiv. Besojmë se do të kemi vazhdimësi të rezultateve, por këto mund të arrihen vetëm me një angazhim të për-bashkët", ka thënë Sokoli.

Kosova e fortë, por nuk po funksionon si grup

Bylbyl Sokoli ka folur edhe për dy ndeshjet e Përfaqësueses së Kosovës në Ligën e Kombeve. Sipas tij, Kosova shënoi fitore të merituar ndaj Ishujve Faroe (2-0), por në të ardhmen duhet të funksionojë si grup nëse dëshiron të jetë edhe më e fortë. "Kosova ka një ekip cilësor dhe ndeshjen e ka fituar me meritë. Nëse duhet një kritikë, mund të them se Kosova ende nuk po funksionon si grup, nuk ka lojë kolektive. Nëse këta individë shfrytëzohen dhe bëhet një lojë kolektive, atëherë Kosova do të jetë shumë e fortë. Zeneli ka qenë individ që ka dëshmuar se Kosova ka ekip të fortë, por nuk duhet t'i harrojmë edhe lojtarët e tjerë si Rashica, Celina Zhegrova, Kryeziu dhe Rrahmani në mbrojtje. Tash për tash lojtarët janë duke funksionuar si individë. Shpresojmë se në të ardhmen do të funksionojë edhe si grup", ka përfunduar Sokoli.



vetvetiu. Besoj se djemtë kanë potencial dhe duhet të shfrytëzohen. Gabimet që po i bëjnë duhet t'i përmirësojnë. Duke pasur parasysh cilësitë e gjithsecilit në ekipin e Llapit, mendoj se duhet të ketë përmirësime që shumë shpejt do të shihen", ka deklaruar ai. Ndeshjen e pestë Llapi e zhvillon në këtë fundjavë kundër

SHKURT

Do të thellohet bashkëpunimi në mes FFK-së dhe FSUK-së

Presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi, e ka pritur në një takim kryetarin e Federatës së Sporteve Universitare të Kosovës, Musa Selimi, me bashkëpunëtorë. "Gjatë këtij takimi Selimi fillimisht e uroi presidentin Ademi për mandatin katërvjeçar në krye të FFK-së si dhe për fitoren e Kombëtares A në Ligën e Kombeve, kurse kërkoi nga FFK-ja bashkëpunim në aktivitete të ndryshme, veçmas në turnetë e futbollit me ekipet e studentëve. Ndërkohë, presidenti Ademi shprehu gatishmërinë për bashkëpunim në të gjitha veprimtaritë me FSUK-në ku është e mundur një gjë e tillë", thuhet në njoftimin e FFK-së.

Bunjaki arrin marrëveshje me Rizesporin

Ish-trajneri i Përfaqësueses së Kosovës, Albert Bunjaki, është afër marrëveshjes me klubin turk Rizespor. Lajmi është bërë me dije nga gazeta suedeze "Aftonbladet" e cila zbulon se palët janë shumë pranë marrëveshjes. "Nënshkrimi i kontratës është çështje kohe. Kanë mbetur edhe disa detaje. Menaxheri im dhe ai i Rizesporit janë duke diskutuar detajet e kontratës. Unë jam gati. Rizespori ka tifozë të shumtë. E di pak turqishten dhe mund ta përmirësoj. Për tre muaj mund të dal në konferencë duke folur turqisht", ka thënë Bunjaki për "Aftonbladet".

Limani: Bekim Isufi, njeriu i rekordeve dhe i sukseseve

Bekim Isufi ka dhënë dorëheqje nga posti i trajnerit në skuadrën e Dritës, pas humbjes që kampionia pësoi nga Llapi (1-2). Largimin e Isufit e ka komentuar edhe kapiteni Ardiyan Limani, i cili e ka vlerësuar "Bekën" si trajner të rekordeve dhe sukseseve. "Ti vetëm fizikisht nuk do të jesh pjesë e jona. Emri yt do të qëndroj gjithmonë me ne, me Dritën. Ti ishe dhe do të mbetesh i Dritës. Faleminderit për gjithçka që na dhe për gati një vit sa ishim së bashku. Na bëre që ta përjetojmë atë që qyteti e priste me vite. Njeriu i rekordeve dhe i sukseseve", ka thënë Limani.

Guardiola dëshiron të pensionohet te Barça

I ka mbetur ende edhe një objektiv për të arritur, të fitojë Ligën e Kampionëve me dy skuadra të ndryshme, por Pep Guardiola ka filluar të mendojë që tani për të ardhmen, ose më saktë për mbylljen e karrierës. "Skuadrat e mia duhet të luajnë futbollin që më pëlqen mua. Hapat e fundit të karrierës dua t'i bëj aty ku e kam filluar, në sektorin e të rinjve. Uroj që kjo të ndodhë te Barcelona", ka thënë trajneri aktual i Manchester Cityt.

Hasani: Pas tri ndeshjeve dihet objektivi i Flamurtarit

Drejtori i Flamurtarit, Agim Hasani, është i kënaqur me katër fitoret në katër ndeshjet e para në IPKO Superligë. Ai ka thënë se, pavarësisht prej këtij fillimi, ende nuk mund të konfirmojë se skuadra kuqezi është kandidatë për titull. "Duhet ta shikojmë se çfarë po bëjmë në këto tri xhiro. Nëse në këto tri xhiro dalim me rezultate pozitive, atëherë do ta paraqesim kandidaturën për titull të kampionit", ka thënë Hasani për "Gazetën Alo". Flamurtari në tri ndeshjet e radhës takohet me Llapin, Trepçën '89 dhe Prishtinën.

Sadiku mund të luajë vetëm për Shqipërinë

TIRANË, 13 SHTATOR - Mbrojtësi Loret Sadiku nuk mund të luajë për ndonjë kombëtare tjetër përveç Shqipërisë. Sadiku ishte bashkuar për herë të parë në fillet e Gianni De Biasit, por që nuk arriti të luante për Shqipërinë. Pastaj ai fitoi të drejtën të luajë për kombëtaren kuqezi, duke kaluar nga

Suedia ku kishte luajtur më parë. Por Sadiku nuk e luajti asnjë ndeshje me Shqipërinë, duke vendosur të kthehet në Kosovë, ku luajti katër ndeshje por që, pas pranimit në FIFA, atij nuk iu lejua. FFK-ja u mundua ta ftojë, por nuk ka arritur, sikurse që nuk ka arritur as Suedia, që ka marrë përgjigje

negative nga FIFA. "Ai nuk mund të luajë për Suedinë, pasi ka ndryshuar një herë përfaqësuese e nuk mund të ndryshojë sërish. Ky është mesazhi që kemi marrë nga FIFA", ka thënë menaxheri i kombëtares suedeze, Stefan Peterson për "footballskanalen.se".



Presidenti Meta, fjalë të mëdha për tifozët 'Kuç e Zi'



TIRANË, 13 SHTATOR - Nga rikthimi në "Elbasan Arena", për ndeshjen e parë të Ligës së Kombeve ndaj Izraelit, ku u lumturuan nga fitorja 1-0, te skocezët, ku provuan të ftohtin e shiut dhe lojës së dobët të kombëtares. Ky ishte itinerari i dhjetëditëshit të parë të shtatorit për tifo-grupin e njohur të kombëtares shqiptare, tifozët "Kuç e Zi". Ndërkohë, të enjten ata e kanë ndaluar hapin në zyrën e presidentit të Republikës, Ilir Meta, i cili njihet si mbështetës i thekur i ekipit kombëtar.

Kreu i shtetit nuk ngurron të bëjë tifo nga stadiumi, kur luan Shqipëria, sikurse e tregoi edhe në mbrëmjen e 7 shtatorit në "Elbasan Arena", kur pozoj duke bërë "shqiponjën" me De Biasin. Takimin e ngrohtë me tifozët "Kuç e Zi" zoti Meta e ka shpërndarë për ndjekësit e vet në "Facebook", ku nënvizon: "Tifozët 'Kuç e Zi' janë frymëzimi i kombëtares tonë dhe, pa dyshim, 'lojtari i 12' i saj. Me dashurinë e jashtëzakonshme për kombin, energjinë e pashter-

shme dhe qytetarinë e tyre, tifozët 'Kuç e Zi' e kanë lartësuar më së miri flamurin shqiptar në arenat sportive. Motivim i jashtëzakonshëm për yjet e kombëtares sonë dhe adrenalinë e paparë për zemrën e çdo shqiptari që rreh për ngjyrat kuç e zi. Me rastin e 15-vjetorit të themelimit të këtij tifo-grupi pata sot kënaqësinë të zhvilloja një takim të përzemërt me një përfaqësi të tyre, të cilët i falënderova për kontributin dhe i inkurajova të jenë përherë pranë kombëtares në sfidat e radhës".

Nowitzki: Luka Donçiqi si Chris Paul

DALLAS, 13 SHTATOR - Fjalët të motivojnë, por ato kanë dyfish vlerë kur i thotë një nga legjendat e basketbollit, si Dirk Nowitzki. Gjermani foli fjalët më të mira për të riun Luka Donçiqi, me të cilin do të jetë shok ekipi tek Dallas Mavericks, duke nisur që nga ky sezon. "Nuk u kam besuar syve. Mendoj se nuk kam parë asnjë lojtar të tillë, të jetë kaq i zoti në moshën 19-20-vjeçare. Arrin të luajë në mënyrë të mrekullueshme 'pick and roll', bën gjithmonë veprimin e duhur, në kohën e duhur. Është shumë i qetë, vizionin e lojës si ai e kam parë te lojtarë të kalibrit të Chris Paulit", ka thënë Nowitzki, i cili është një nga gjashtë lojtarët e vetëm që ka arritur kuotën e 30 000 pikëve në karrierë e me plot gojë mund të thuhet se është lojtari evropian më i suksesshëm në historinë e NBA-së. Gjermani kujton se edhe ai ka pasur vështirësi në vitin e parë në Amerikë, gjë që mund të ndodhë edhe me 19-vjeçarin. "Nuk është



e lehtë të përshtatesh kur vjen nga një vend tjetër. Çdo gjë është e re. Niveli, trajnerët apo stili i lojës. Viti im i parë ishte shumë i vështirë, por këtu në Dallas ne do ta ndihmojmë Lukan në çdo mënyrë që ai të shprehë më së miri lojën e tij", ka deklaruar Nowitzki. Donçic njihet si një nga talentët

evropianë më të mirë të të gjitha kohëve. Shpeshherë është krahasuar me legjendën kroate Dražen Petrović. Në sezonin e kaluar sloveni ishte pjesë e Realit të Madridit, ku arriti ta fitonte kampionatin dhe Euroligën, madje arriti të shpallej MVP i kompeticionit më madhor evropian për klube.

SHKURT

"La 10 Sport": Neymari ka marrëveshje me Realin

Neymari duket gjithmonë e më pranë Realit. Së fundmi, media franceze "Le 10 Sport" nëpërmjet një lajmi ekskluziv tregon se babai i futbollistit brazilian, i cili është edhe menaxheri i tij, ka qenë në kontakt të vazhdueshëm me Real Madridin. Sipas medieve franceze, mes palëve është arritur një marrëveshje paraprake e cila pritet të konkretizohet në pranverën e ardhshme. "La 10 Sport" nuk zbulon shifra dhe detaje nga kjo marrëveshje, po është e bindur se në verën e 2019-s Neymari do të jetë lojtar i Real Madridit. Priten me mjaft interes zhvillimet në ditët e ardhshme.

Mulleri: E kemi mendjen te Liga e Kampionëve

